

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

P. nr. 54/17

25 maj 2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS, në Trupin Gjykes të përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Arnout Louter si Kryetar i Trupit Gjykes dhe Gjyqtarët e EULEX-it Dariusz Sielicki dhe Radostin Petrov si Anëtarë të Trupit Gjykes, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjor të EULEX-it Chiara Tagliani si Procesmbajtëse në lëndën penale kundër:

Z. V., nofka **Z.**, , kombësia **S.** dhe shtetësia **S.**, në paraburgim në këtë rast që nga 11 nëntori 2016;

I akuzuar përmes Aktakuzës PPS nr. 60/2012 të ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) më 20 prill 2017, të ndryshuar më 17 prill 2018, për akuzat e përshkruara si më poshtë:

AKUZA I

Se, në kundërshtim me Nenin 3 të përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949, dhe të Neneve 4, 5 (1) dhe 13 të Protokollit II të 8 qershorit 1977, shtesë të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të gjitha rregullave të së drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës që lidhet me Aktakuzën e tanishme, i Akuzuari, në mes të datës 2 maj 1999 dhe 3 maj 1999, në cilësinë e tij si polic rezervë nga stacioni i policisë në V. me përgjegjësi personale dhe/ose duke vepruar në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të forcave të ndryshme Serbe (duke përfshirë edhe Policinë rezervë dhe paramilitarët) morën pjesë në një sulm ndaj popullatës civile etnike Shqiptare që udhëtonte në një kolonë midis S. së E. dhe S. së P., gjatë të cilit sulm civilët i'u nënshtruan qëllimisht vrasjeve brutale dhe të paligjshme, trajtimit çnjerëzor, vuajtjeve të mëdha, përzënies dhe zhvendosjes, zbatimit të masave të frikësimit dhe terrorit, konfiskimit të pronës, plaçkitjes dhe vjedhjes në shkallë të gjerë të pronës që nuk u justifikua nga nevojat ushtarake. Në mesin e atyre civilëve të vrarë, të plagosur dhe të nënshtruar ndaj trajtimit çnjerëzor për të cilin i Akuzuari mban përgjegjësi çoftë të drejtpërdrejt ose në bashkëkryerje me të tjerët, ishin: E. M., Xh. M., F. (A.) G., E. R., A. B., Rr. A., B. G., A. G., B. G. dhe një djalë 14 vjeç i pidentifikuar si dhe H. A., Sh. G. dhe M. G.;

AKUZA III

Se, në kundërshtim me Nenin 3 të përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949, dhe të Neneve 4, 5 (1) dhe 13 të Protokollit II të 8 qershorit 1977, shtesë të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të gjitha rregullat e së drejtës ndërkombëtare

në fuqi në kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe gjithë kohën në lidhje me Aktakuzën e tanishme, i Akuzuari, në mes të datës 3 maj 1999 dhe fillimit të qershorit 1999, në cilësinë e tij si polic rezervë nga Stacioni i Policisë në V., pastaj duke vepruar si roje burgu, me përgjegjësi personale dhe/ose duke vepruar në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të forcave të ndryshme Serbe (duke përfshirë edhe Policinë rezervë) kanë marrë pjesë në ndalimin e paligjshëm të një numri të madh të popullatës civile etike Shqiptare, në Burgun e S., rajoni i M., duke përfshirë S. K., B. F., M. U., F. P., B. M., Sh. B., G. H., A. O., S. O., I. F., D. F., S. G., S. G., S. H., Sh. M., S. Rr., R. A., gjatë së cilit ata i'u nënshtruan me qëllim nga i Akuzuari një trajtimi çnjerëzor dhe vuajtje të pafundme përmes shkaktimit të torturës, rrahjeve dhe / ose shkeljeve të integritetit trupor dhe shëndetit si dhe zbatimit të masave të frikësimit dhe terrorit;

ndërsa këto veprime janë klasifikuar në Aktakuzë si **Krime Luftë kundër Popullsisë Civile**, të parashikuara dhe të dënuara nga Nenet 22 dhe 142 të KPRSFJ-së, aktualisht të kriminalizuara nga Nenet 31, 152 dhe 153 të KPK-së, në kundërshtim me Nenin 3 të përbashkët të katër Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe të Neneve 4, 5 (1) dhe 13 të Protokollit II të 8 qershorit 1977, shtesë të Konventave të Gjenevës të vitit 1949;

Pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit kryesor, të gjitha të hapura për publikun, më 26, 27 dhe 28 shtator 2017, 4, 11 dhe 16 tetor 2017, 7, 8, 9, 13, 14, 17, 29, 30 nëntor 2017, 4, 5, 6, 7 dhjetor 2017, 14 shkurt 2018, 17 dhe 19 prill 2018, 23 maj 2018, të gjitha në praninë e të Akuzuarit Z. V. dhe avokatit të tij mbrojtës N. V., prokurorin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (Prokurori), përfaqësuesi i palës së dëmtuar, dhe duke pasur palët e dëmtuara H. A., Sh. G., M. G., V. (K) M., I. M., L. M., A. G., S. K., M. M., M. U., F. Parduzi, Bekim Musa, Shefket Binaku, Gani Hajredinaj, Azem Osmani, Sefer Osmani, Izet F., D. F., S. G., S. G., B. F., janë informuar në mënyrë të rregullt për datat dhe vendin e të gjitha seancave gjyqësore;

ndërsa Sh. G. dhe V. K. M. ishin të pranishëm më 26 shtator 2017, V. K. M. dhe L. M., ishin të pranishëm më 27 dhe 28 shtator 2017 më 4, 11 dhe 16 tetor 2017 më 7, 9, 17 nëntor 2017, më 07 dhjetor 2017, dhe më 17 dhe 19 prill 2018, B. G. ishte e pranishme më 16 tetor 2017 dhe E. M. A. ishte e pranishme më 09 nëntor 2017; për më tepër, V. K.-M. dhe L. M. ishin të pranishme gjatë vizitës në terren më 22 shkurt 2018;

Pas zhvillimit të vizitës në terren më 22 shkurt 2018 në praninë e Prokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (Prokurorisë), përfaqësuesit të palës së dëmtuar dhe avokatit mbrojtës N. V.;

Pas shqyrtimit dhe votimit të Trupit Gjyqësor të mbajtur më 23 dhe 24 maj 2018;

Në pajtim me Nenin 366 Paragrafi (1) i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP) me 25 maj 2018 në seancë publike dhe në prani të të Akuzuarit, avokatit të tij mbrojtës, Përfaqësuesit të palëve të dëmtuara dhe Prokurorit të Shtetit;

Merr këtë:

AKTGJYKIM

I.

AKUZA I

Akuzuari **Z. V.** shpallet **I PAFAJSHËM**, për shkak se:

Nuk është vërtetuar se i Akuzuari, në mes të 2 majit 1999 dhe 3 majit 1999, në cilësinë e tij si polic rezervë nga Stacioni i Policisë në V., me përgjegjësi personale dhe/ose duke vepruar në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të forcave të ndryshme Serbe (përfshirë edhe Policinë rezervë dhe paramilitarët) morën pjesë në një sulm ndaj popullatës civile etnike Shqiptare që udhëtonte në një kolonë midis S. së E. dhe S. së P., gjatë të cilit civilët i'u nënshtruan qëllimisht vrasjeve brutale dhe të paligjshme, trajtimit çnjerëzor, vuajtjeve të mëdha, largimit dhe zhvendosjes, zbatimit të masave të frikësimit dhe terrorit, konfiskimit të pronës, plaçkitjes dhe vjedhjes në shkallë të gjerë të pronës që nuk u justifikua nga nevojat ushtarake. Në mesin e atyre civilëve të vrarë, të plagosur dhe të nënshtruar trajtimit çnjerëzor për të cilin i Akuzuari mban përgjegjësi çoftë në mënyrë të drejtpërdrejt ose në bashkëkryerje me të tjerët ishin: E. M., Xh. M., F. (A) G., E. R., A. B., Rr. A., B. G., A. G., B. G. dhe një djalë 14 vjeç i pidentifikuar, si dhe H. A., Sh. G. dhe M. G.

Prandaj, në pajtim me Nenin 364, paragrafi (1) nënparagrafi (1.3) të KPP, i akuzuari **Z. V.**, me këtë rast, **LIROHET** nga akuza e kryerjes së veprës penale të **krimeve të luftës kundër popullatës civile**, të parashikuara dhe të dënueshme me Nenet 22 dhe 142 të KPRSFJ, aktualisht të kriminalizuar nga Nenet 31, 152 dhe 153 të KPK, në kundërshtim me Nenin 3 të përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe të Neneve 4, 5 (1) dhe 13 të Protokollit II të 8 Qershor 1977, përveç konventave të Gjenevës të vitit 1949.

II.

AKUZA III

I Akuzuari **Z. V.** shpallet **FAJTOR**, sepse:

Është vërtetuar se i Akuzuari, në mes 3 majit 1999 dhe fillimit të qershorit 1999, në cilësinë e tij si polic rezervë nga stacioni i policisë së V., atëherë duke vepruar si roje e burgut, duke vepruar qëllimisht dhe në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të forcave Serbe, ndërsa një numër i madh i popullatës civile etnike shqiptare u mbajtën në paraburgim në Burgun e S., Rajoni i M., përfshirë S. K., B. F., M. U., F. P., B. M., Sh. B., G. H., A. O., S. O., I. F., D. F., S. G., S. G., S. H., Sh. M., S. R., R. A., iu nënshtruan trajtimit çnjerëzor dhe vuajtjeve të pafundme përmes shkakimit të rrahjeve, shkeljeve të integritetit trupor dhe shëndetit sikurse edhe zbatimin e masave të frikësimit dhe terrorit.

Prandaj, i akuzuari **Z. V.** është **DËNUAR** për kryerjen e veprës penale të **krimeve të luftës kundër popullatës civile**, të paraparë dhe të dënuar nga Nenet 22 dhe 142 të KPRSFJ, aktualisht të kriminalizuara me Nenet 31, 152 dhe 153 të KPK, në kundërshtim me Nenin 3 të përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe nenet 4, 5 (1) dhe 13 të Protokollit II të 8 qershorit 1977, shtesë të Konventave të Gjenevës të vitit 1949.

III.

I akuzuari Z. V. me këtë rast është

DËNUAR

me **gjashtë (6) vjet dhe gjashtë (6) muaj burgim** në përputhje me Nenin 142 në lidhje me Nenin 22 të KPRSFJ, në formulimin që ka hyrë në fuqi më 1 korrik 1977, që kishte mbetur në fuqi me Nenin 1, paragrafi 1.3 Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 e 12 dhjetorit 1999.

Koha e kryer në paraburgim që nga arrestimi i parë i të Akuzuarit më 10 mars 2016 duhet të përfshihet në dënimin me burgim në pajtim me Nenin 50 paragrafi (1) dhe (3) të KPRSFJ.

IV.

Kërkesa pronësore

Në bazë të nenit 463 të KPPK-së, kërkesat pronësore të paraqitura nga palët e dëmtuara do të hidhen poshtë. Palët e dëmtuara mund të paraqesin të gjitha kërkesat e tyre pronësore në proceset civile gjyqësore.

V.

Shpenzimet e procedurës

Sipas Nenit 453 Paragrafi 4 i KPPK-së, kostoja e procedurës penale do të rimbursohet pjesërisht nga i Akuzuari Z. V. në një shumë paushall prej 300 Euro, ndërsa çfarëdo kosto e mbetur e procedurës penale do të paguhet nga burimet buxhetore.

ARSYETIMI

A. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 20 prill 2017, Prokurori i EULEX-it në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (Prokurori) ka ngritur Aktakuzën PPS nr. 60/2012 kundër të Pandehurit **për tri** akuza të **Krimeve të Luftës kundër Popullatës Civile**, të parapara dhe të dënuara nga Nenet 22 dhe 142 të KPRSFJ, aktualisht të kriminalizuara nga Nenet 31, 152 dhe 153 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), në shkelje të Nenit 3 të përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe të Neneve 4, 5 (1) dhe 13 të Protokollit II të 8 qershorit 1977, shtesë të Konventave të Gjenevës të vitit 1949.
2. Më 29 maj 2017, Kryetari i Trupit Gjykses e mbajti një seancë fillestare në pajtim me Nenin 245 të KPP dhe, më pas, Mbrojtja e dorëzoi një kërkesë për hedhjen poshtë të aktakuzës të cilës me kohë i'u përgjigj Prokurori.
3. Më 27 korrik 2017, u lëshua vendimi për kërkesën e mbrojtjes për hedhjen poshtë të pikës 2 të aktakuzës PPS 60/2012, me ç'rast u miratua kërkesa e mbrojtjes dhe Pika 2 e Aktakuzës u hodh poshtë. Duhet të theksohet se Prokurori nuk e ka kundërshtuar Kërkesën e Mbrojtjes për hedhjen poshtë të Pikës 2.
4. Në të njëjtin Vendim për Aktakuzën, Kryetari i Trupit Gjykses i dërgoi Pikat e mbetura, domethënë Pikën 1 dhe Pikë 3, për Gjykim. Ky vendim nuk ishte subjekt i ndonjë Ankese nga palët.
5. Njëkohësisht, më 27 qershor 2017, Mbrojtja e dorëzoi një kërkesë për bashkimin e të gjitha procedurave në vazhdim kundër të Pandehurit, në veçanti PPS 90/14 dhe PPS 49/2009, pasi ato gjithashtu kishin të bënin me akuzat për Krime Luftë gjatë të njëjtës kornizë kohore dhe Aktakuzat gjithashtu ishin ngritur edhe në këto raste.
6. Pas marrjes së Përgjigjes së Prokurorit, me të cilën Prokurori e ka kundërshtuar kërkesën e paraqitur, meqë rastet kanë të bëjnë me incidente të ndryshme dhe të dallueshme, më 27 korrik 2017, Gjykata e hodhi poshtë kërkesën e mbrojtjes si të palejueshme, pasi ajo ishte paraqitur nga një person i paautorizuar.
7. Shqyrtimi gjyqësor u hap më 26 shtator 2017 dhe vazhdoi më 27 dhe 28 shtator 2017, 4, 11 dhe 16 tetor 2017, 7, 8, 9, 13, 14, 17, 29, 30 nëntor 2017, 7 dhjetor 2017, 14 dhe 22 shkurt 2018, 17 dhe 19 prill 2018, dhe 23 maj 2018.
8. Më 17 prill 2018, Prokurori e ndryshoi aktakuzën¹.
9. Dispozitivi i Aktgjykimit u shpall më 25 maj 2018.
10. Në pajtim me Nenin 541 të Kodit të ri të Procedurës Penale (KPP) i cili hyri në fuqi më 1 Janar 2013², Gjykimi u zhvillua sipas dispozitave të Kodit të ri të Procedurës Penale të Kosovës (KPP).

¹ Shih Aktakuzën e Ndryshuar të paraqitur në Gjykatë më 17 prill 2018.

² KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE.

B. KOMPETENCA E GJYKATËS

11. Ligji për Gjykatat , Ligji nr.03/L-199 (LGj) hyri gjithashtu plotësisht në fuqi më 1 janar 2013 (Neni 43). Ky e rregullon kompetencën vendore dhe lëndore të Gjykatës.
12. Sipas Nenit 11 paragrafi (1) të Ligjit për Gjykatat, Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha lëndët, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj.
13. Neni 9 Paragrafi (2) Nënparagrafi (2.7) i të njëjtit Ligj thotë se Gjykata Themelore e M. është themeluar për territorin e K. të M. J. dhe M. V., L., Z. P., Z., S. dhe V.
14. Në bazë të aktakuzës së ngritur, veprat penale të pretenduara kanë ndodhur në komunën e V. dhe, për rrjedhojë, brenda kompetencës vendore të Gjykatës Themelore të M., sipas Nenit 29 Paragrafi (1) i KPP.
15. Sipas Nenit 15 Paragrafi (1) Nënparagrafi (1.2) të Ligjit të lartpërmendur për Gjykatat, veprat penale të 'Krimeve të Luftës' bien në kompetencë të Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore. Prandaj, rasti u gjykua nga Departamenti për Krime të Rënda të Gjykatës Themelore të M.
16. Pas ngritjes së aktakuzës, Kryetari i Gjyqtarëve të EULEX-it iu drejtua me një kërkesë me shkrim Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) që t'i caktojë këtë rast një trupi gjykues të përbërë nga shumica e gjyqtarëve të EULEX-it dhe një gjyqtar i EULEX-it si Kryetar i trupit gjykues në pajtim me Nenin 3.2, 3.5 dhe 3.6 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në lidhje me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës - Ligji nr.05/L-103.
17. Më 18 maj 2017, Njësia e Gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën Themelore të M. e mori Vendimin e KGJK-së nr. 127/2017, datë 27 prill 2017, që e cakton çështjen penale P nr. 54/2017 një kolegji të përbërë nga gjyqtarë të EULEX-it dhe një Gjyqtar i EULEX-it si Kryetar i Trupit Gjykues.
18. Asnjë kundërshtim nuk është ngritur për përbërjen e Trupit Gjykues.

C. GJYKIMI

19. Seancat e gjyqimit ishin të gjitha hapura për publikun dhe ato u mbajtën më 26, 27 dhe 28 shtator 2017, 4, 11 dhe 16 tetor 2017, 7, 8, 9, 13, 14, 17, 29, 30 nëntor 2017, 4, 5, 6, 7 dhjetor 2017, 14 shkurt 2018, 17 dhe 19 prill 2018, dhe 23 maj 2018.
20. Një vizitë në terren u zhvillua më 22 shkurt 2018 në të gjitha vendet e veprave penale të pretenduara.

21. Për shkak të gjatësisë së pazakontë të dëshmimeve të dëshmitarëve për ndjekjen penale, kohëzgjatja e gjykimit e tejkaloj periudhën prej 120 ditësh kalendarike të parashikuara në Nenin 314 paragrafi (1.2) të KPP.
22. Megjithatë, çdo shtyrje e urdhëruar nga Trupi Gjykses është arsytuar gjithmonë me shënimin e veprimeve procedurale që do të ndërmerren gjatë seancës së ardhshme të Gjykatës
23. Në bazë të nenit 16 të Ligjit mbi jurisdikcionin dhe kompetencat e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, gjuha e përdorur në procedurën gjyqësore ishte gjuha Angleze.
24. Në pajtim me Nenin (14) të KPP, përkthyesit përkthyen procedurat gjyqësore dhe të gjitha dokumentet e Gjykatës relevante për gjykim nga Anglishtja në Serbisht dhe Shqip, dhe anasjelltas.
25. Saktësia e procesverbalit të shkruar në të njëjtën kohë ishte kontrolluar nga Kryetari i Trupit Gjykses në kohë reale përmes shfrytëzimit të një ekrani dhe kjo mënyrë e regjistrimit bëri të mundur përdorimin e metodave të tjera të regjistrimit të tepërta pasi që duket se nuk ka gjasa të arrijë ndonjë saktësi më të mirë të përmbajtjes semantike të procesverbalit.
26. Gjatë seancës së gjykimit të 26 shtatorit 2017, i akuzuari deklaroi se nuk ishte fajtor për të dy pikat.
27. Gjatë seancave të 14 dhe 30 nëntorit 2017, 7 dhjetor 2017 dhe 14 shkurt 2018, avokati mbrojtës i të pandehurit, avokati N. V., u zëvendësua nga avokati mbrojtës Lj. P.
28. Përfaqësuesit e Palëve të Dëmtuara, gjegjësisht përfaqësuesit e Zyrës së mbrojtësit të Viktimave, ishin të pranishëm në të gjitha seancat dhe të gjitha Palët e Dëmtuara u informuan në mënyrë të rregullt për seancat e planifikuara të gjykimit.
29. Palët e dëmtuara në vijim ndoqën seancat në vijim: Sh. G. dhe V. K. M. ishin të pranishëm më 26 shtator 2017, V. K. M. dhe L. M. ishin të pranishëm më 27 dhe 28 shtator 2017 më 4, 11 dhe 16 tetor 2017 më 7, 9, 17 nëntor 2017, më 7 dhjetor 2017 dhe më 17 dhe 19 prill 2018, B. G. ishte e pranishme më 16 tetor 2017 dhe E. M. A. ishte e pranishme më 9 nëntor 2017. Për më tepër, V.K. M. dhe L. M. ishin të pranishme gjatë vizitës në terren të 22 shkurtit 2018.

D. PROCEDURA E PROVAVE

i) Dëshmitë e paraqitura gjatë shqyrtimit kryesor

30. Gjatë rrjedhës së gjykimit u dëgjuan Dëshmitarët e Prokurorisë në vijim:
 - Dëshmitari S. K. më 27 Shtator 2017;

- Dëshmitarja R. M. më 28 Shtator 2017;
- Dëshmitari Sh. G. më 28 Shtator 2017;
- Dëshmitari N. G. më 04 Tetor 2017;
- Dëshmitari B. A. më 11 Tetor 2017;
- Dëshmitari H. A. më 11 Tetor 2017;
- Dëshmitari I. P. më 16 Tetor 2017;
- Dëshmitari B. F. më 16 Tetor 2017;
- Dëshmitari S. G. më 07 Nëntor 2017;
- Dëshmitari M. U. më 08 Nëntor 2017;
- Dëshmitari G. H. më 08 Nëntor 2017;
- Dëshmitari Sh. G. më 09 Nëntor 2017;
- Dëshmitari F. P. më 09 Nëntor 2017;
- Dëshmitari Sh. M. më 13 Nëntor 2017;
- Dëshmitari B. M. më 13 Nëntor 2017;
- Dëshmitari Sh. B. më 14 Nëntor 2017;
- Dëshmitari S. H. më 14 Nëntor 2017;
- Dëshmitari M. G. më 17 Nëntor 2017;
- Dëshmitari B. A. më 17 Nëntor 2017;
- Dëshmitari D. F. më 29 Nëntor 2017;
- Dëshmitarja T. Rr. më 30 Nëntor 2017;
- Dëshmitari A. O. më 04 Dhjetor 2017;
- Dëshmitari I. F. më 04 Dhjetor 2017;
- Dëshmitari S. O. më 07 Dhjetor 2017;
- Dëshmitari S. G. më 14 Shkurt 2018.

31. Gjatë rrjedhës së gjykimit u dëgjuan Dëshmitarët e mëposhtëm të propozuar nga Përfaqësuesi i Palëve të Dëmtuara:

- Dëshmitari S. (H) Rr. më 06 Dhjetor 2018;
- Dëshmitari R. (H) A. më 06 dhjetor 2018;
- Dëshmitarja B. (S.) G. më 07 Dhjetor 2018.

32. Trupi Gjykues nuk ishte në gjendje të dëgjonte Dëshmitarët e propozuar nga Mbrojtja, siç është shpjeguar më poshtë.

33. Gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor, këto dëshmi ishin administruar si prova materiale:

- prova materiale 1: skica e vrasjes së E. R. dhe A. B. të shënuar nga Dëshmitari N. G., e administruar gjatë seancës gjyqësore të datës 04 tetor 2017;
- Prova materiale 2: skica e vrasjes së një djali të pidentifikuar të shënuar nga Dëshmitari N. G., e administruar gjatë seancës gjyqësore të datës 04 tetor 2017;
- Prova materiale 3: skica e vrasjes së E. dhe Xh. M. siç është shënuar nga Dëshmitari N. G., e administruar gjatë seancës gjyqësore të datës 04 tetor 2017;
- Prova materiale 4: skica e vrasjes së F. G. siç është shënuar nga Dëshmitari N. G., e administruar gjatë seancës gjyqësore të datës 04 tetor 2017;
- Prova materiale 5: grup i fotografive të Burgut të S., të administruara gjatë seancës gjyqësore të 16 tetorit 2017;

- Prova materiale 6: fotografia numër 14 i grupit të lartpërmendur të fotografive të shënuar nga Dëshmitari M. U., e administruar gjatë seancës gjyqësore të 08 nëntorit 2017;
 - Prova materiale 7: skica e vrasjes së një djali të pidentifikuar të shënuar nga Dëshmitari Sh. G., e administruar gjatë seancës gjyqësore të datës 09 nëntor 2017;
 - Prova materiale 8: skica e vrasjes së një djali të pidentifikuar të shënuar nga Dëshmitari M. G., e administruar gjatë seancës gjyqësore të 17 nëntorit 2017;
 - Prova materiale 9: Raporti i policit për takimin me Dëshmitaren B. G., e administruar gjatë seancës gjyqësore të datës 07 dhjetor 2017.
34. Gjatë seancës gjyqësore të datës 17 prill 2018, Trupi Gjykes administroi Listën Përfundimtare të provave të propozuar nga Prokuroria (Lista)³. Mbrojtja nuk e ka kundërshtuar Listën. Përveç provave materiale të administruara tashmë nga Gjykata, Lista përmbante, inter alia, provat në vijim:
- REGJISTRATORI I - EULEX Deklaratat e Dëshmitarëve:
 - S. K. - rreshtimi fotografik, i 16 nëntorit 2015;
 - N. G. - rreshtimi fotografik, i datës 13 nëntor 2015;
 - B. A. - rreshtimi fotografik, i datës 15 mars 2016;
 - B. F. - rreshtimi fotografik, i datës 17 janar 2017;
 - M. U. - rreshtimi fotografik, i datës 9 dhjetor 2015.
 - REGJISTRATORI II - EULEX Deklaratat e Dëshmitarëve:
 - B. A. - rreshtimi fotografik, i datës 15 mars 2016;
 - B. F. - rreshtimi fotografik, i datës 17 janar 2017;
 - M. U. - rreshtimi fotografik, i datës 9 dhjetor 2015.
 - REGJISTRATORI IV - EULEX Deklaratat e Dëshmitarëve:
 - D. F. - rreshtimi fotografik, i datës 23 mars 2017;
 - S. O. - rreshtimi fotografik, i datës 30 mars 2017.
 - REGJISTRATORI V - Raportet e KFORit, Tribunali i Hagës, UNMIKut dhe Policisë së EULEX-it dhe Raportet hetuese (siç janë elaboruar në mënyrë të plotë në Listë)
 - REGJISTRATORI V (a) - RAPORTET E AUTOPSISË dhe materialet dhe korrespondencat e ndërlidhura (siç janë elaboruar në mënyrë të plotë në Listë)

³ Shih PPS 60/2012 - Lista përfundimtare e provave të propozuara nga Prokuroria të dorëzuar më 17 prill 2018.

- REGJISTRATORI IX DEKLARATAT E DËSHMITARËVE UNMIK / TNKJ
 - Deklarata në polici e N. G., rreshtimi fotografik, i datës 16 gusht 2005.
 - REGJISTRATORI XIII - ICTY CDS DHEPROVAT MATERIALE (siç është elaboruar në mënyrë të plotë në listë)
35. Gjatë seancës së njëjtë gjyqësore, Trupi Gjyqësor administroi një provë të paraqitur nga Avokati Mbrojtës i të Pandehurit më 23 mars 2018 lidhur me artikujt e lajmeve për të pandehurin, siç është elaboruar më poshtë. Prokurori nuk e kundërshtoi këtë dëshmi.
 36. Të gjitha provat u konsideruan si dëshmi të pranueshme.
 37. I pandehuri nuk e ka dhënë ndonjë deklaratë gjatë fazës së provave.

ii) Kërkesat⁴

- **Kërkesat e Prokurorisë**

- Kërkesa e Prokurorisë për Tërheqjen e Dëshmitarit M. M.

38. Më 6 mars 2018, Prokurori i paraqiti Gjykatës një Kërkesë për Tërheqjen e Dëshmitarit M. M., duke e konsideruar si të pamundur që Dëshmitari të paraqitej në Gjykatë dhe në për shkak të faktit se ngjarjet që Dëshmitari do të tregonte, përkatësisht Pika I e Aktakuzës, tashmë ishin paraqitur nga Dëshmitarët e tjerë. Siç dëshmohet në të gjithë procedurën e Gjykatës, Gjykata kishte provuar disa herë që të thërrasë Dëshmitarin, por pa rezultate.
39. Më 17 prill 2018, Trupi Gjyqësor e miratoi kërkesën në pajtim me Nenin 258 të KPP dhe Prokurori e hoqi emrin e Dëshmitarit në versionin e ndryshuar të Aktakuzës.

- Kërkesa e Prokurorisë për Prova të Reja që të pranohen gjatë shqyrtimit gjyqësor

40. Më 06 mars 2018, Prokurori e paraqiti një Kërkesë për Dëshmi të Reja për t'u pranuar gjatë shqyrtimit gjyqësor në pajtim me Nenin 329 Paragrafët (3) dhe (4) të KPP, me ç'rast kërkoi nga Gjykata që të pranojë si dëshmi të reja provat materiale të Tribunalit të Hagës P02335 të administruar gjatë lëndës së TNKJ Rasti ' M. et al'⁵.

⁴ Për të gjitha kërkesat, shih Regjistratorin Pnr 54/17 "Kërkesat".

⁵ Prokurori kundër M. et al., Aktgjykimi i datës 26 shkurt 2009, IT-05-87-T.

41. Prova materiale në fjalë përmban një përgjigje nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Serbisë për TNKJ me informacionin e marrë nga Ministria e Brendshme e Republikës së Serbisë lidhur me personat që ishin anëtarë të MPB (Shërbimet Policore) në Kosovë dhe stacionet e policisë ku ishin caktuar në vitin 1999.
42. Pika 5 në faqen e shënuar K0530291 emëron të pandehurin Z. V. si "...polic rezervë në SPB V.".
43. Prokurori kërkoi pranimin e një dokumenti të tillë duke marrë parasysh vlerën e saj provuese dhe dëshmuese.
44. Prova nuk u kundërshtua nga Mbrojtja.
45. Më 17 prill 2018, Trupi Gjykses e miratoi Kërkesën në pajtim me Nenin 329 Paragrafi (4) të KPP.

- Kërkesa e Prokurorisë për Njoftimin Gjyqësor për Faktet e Gjykuara

46. Më 09 mars 2018, Prokurori paraqiti një Kërkesë për Njoftim Gjyqësor për Faktet e Paragjykura, ku kërkoi nga Gjykata të pranojë si fakte të vërtetuara të cilat janë gjetur si të provuara në jurisprudencën e Tribunalit të Hagës në lidhje me ekzistimin e një konflikti të armatosur në Kosovë. Në këtë drejtim, Prokurori i bashkëngjiti kërkesës disa vendime të Tribunalit të Hagës, si dhe jurisprudencën nga gjykatat vendore të Kosovës.
47. Mbrojtja nuk e kundërshtoi këtë kërkesë.
48. Më 17 prill 2018, Trupi Gjykses e miratoi Kërkesën në pajtim me Nenin 329 Paragrafi (4) të KPP.

- **Kërkesat e Mbrojtjes**

- Kërkesa për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike (NNJ) për Dëshmitarët e Mbrojtjes

49. Më 27 qershor 2018, në pajtim me Nenin 256 të KPP, avokati mbrojtës e paraqiti një listë të emrave të Dëshmitarëve që do të thirren për të dëshmuar para Trupit Gjykses si Dëshmitarë të Mbrojtjes. Këta Dëshmitarë, siç pohohet nga Mbrojtja, ishin ose rezervistë të policisë në V. në kohën kritike ose oficerë komandues të stacionit policor në V.
50. Dëshmitarët gjoja banojnë në Republikën e S. dhe në propozimin e tij avokati mbrojtës deklaroi se prokurori dy herë kishte paraqitur kërkesë për ndihmë

autoriteteve gjyqësore të Republikës së S. me qëllim që t'i dëgjonte këta Dëshmitarë , por pa ndonjë rezultat.

51. Më 21 nëntor 2017, Gjykata e lëshoi një kërkesë për ndihmë të ndërsjellë juridike tek autoritetet përkatëse në Republikën e S., duke u kërkuar kështu autoriteteve S. që së pari të gjejnë Dëshmitarët e përmendur dhe, pasi të jenë gjetur, t'u dorëzojnë atyre thirrjet përkatëse dhe të organizojnë, së bashku me zyrtarët e Gjykatës, në Kosovë seanca me video-lidhje.
52. Më 30 janar 2018, Gjykata pranoi nga Ministria e Drejtësisë e K. një Përgjigje të dërguar më 26 dhjetor 2017 nga Ministria e Drejtësisë e S. me një deklaratë të Departamentit të Krimeve të Luftës së Gjykatës së Lartë në Beograd të datës 22 dhjetor 2017 , ku Gjykata e Lartë deklaroi se nuk mund të vazhdonte me kërkesën për të thirrur Dëshmitarët për shkak të mungesës së të dhënave të tyre personale dhe adresave të sakta.
53. Pas interesimit me avokatin mbrojtës lidhur me mundësinë për të marrë më shumë të dhëna personale për Dëshmitarët, dhe me marrjen e përgjigjes negative me 2 shkurt 2018 lidhur me këtë çështje, me 16 shkurt 2018, Gjykata e dha një përgjigje për autoritetet S. duke e rinovuar Kërkesën për përpjekjet që duhet të bëhen nga autoritetet kompetente përkatëse në S. për të gjetur Dëshmitarët dhe, pasi të jenë gjetur, të thirren ata të paraqiten para Gjykatës me anë të video-lidhjes.
54. Më 09 mars 2018, Gjykata e pranoi një njoftim të lëshuar nga Gjykata e Lartë në B. më 05 shkurt 2018, me të cilin vërtetohej hedhja poshtë e Kërkesës.
55. Prandaj, Trupi Gjykues duhej të refuzonte kërkesën e Mbrojtjes për të thirrur Dëshmitarët në pajtim me Nenin 258 (2) (2.3) të KPP, pasi që ishte e paarritshme.

- Kërkesa për plotësimin e procedurës penale

56. Më 23 mars 2018, avokati mbrojtës i të pandehurit e paraqiti një kërkesë për plotësimin e procedurës penale me qëllim të futjes së tre artikujve të lajmeve publikisht të disponueshëm në internet të cilat u publikuan me fotografi të të pandehurit dhe që kanë të bëjnë me arrestimin e të pandehurit në mars 2016, ekstradimin e tij në nëntor 2016 dhe datën kur u ngrit Aktakuza në prill 2017.
57. Avokati mbrojtës propozoi për të prezantuar këtë dëshmi si një provë e paragjyimit të fajësisë ndaj klientit të tij dhe anshmërisë në identifikimin e tij.
58. Prokuroria nuk i ka kundërshtuar provat.
59. Më 17 prill 2018, Trupi Gjykues e miratoi Kërkesën në pajtim me Nenin 329 Paragrafi (4) i KPP.

E. GJETJET FAKTIKE

E.1. Përmbledhje e fakteve të provuara

60. Gjykata duhej të përcaktonte se cilat fakte të vërtetuara janë në bazë të provave të administruara kundër të akuzuarit Z. V. për veprat penale të krimeve të luftës.
61. Me provat e pranura të paraqitura dhe të administruara gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor dhe në dritën e fakteve të vendosura tashmë nga Dhomat Gjyqësore të Tribunalit të Hagës për të cilat Trupi Gjyqësor mori njoftim gjyqësor, Gjykata mori në konsideratë faktet relevante si të provuara përtej dyshimit të arsyeshëm .
- Më 2 maj 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan një numër fshatrash në veri-lindje të qytetit të V., duke përfshirë S., S., C. dhe S. e E. Fshatarët u detyruan të largoheshin nga shtëpitë e tyre dhe shumë prej shtëpive, dyqaneve dhe objekteve fetare u dogjën plotësisht. Fshatarët, të përbërë kryesisht nga civilët si dhe personat e zhvendosur më parë nga vendbanime të tjera në komunën e V., u detyruan të formonin një kolonë prej 30,000 deri në 50,000 njerëz që udhëtonin në rrugën "S. G.", në drejtim të qytetit të V.. Nga mbremja e 2 majit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë të përbëra nga Ushtria e rregullt Serbe, Paramilitarët Serbë, policia dhe rezervistët policor në mënyrë të përsëritur sulmuan kolonën dhe ngacmuan, kërcënuan, rrahën dhe vranë një numër të madh të shqiptarëve të Kosovës dhe vodhën dhe plaçkitën gjësende me vlerë të shumë të tjerëve.
 - Në këtë sulm u vranë këta civil Shqiptarë: E. M., Xh. M., E. R., F. (A) G., A. B., B. G., A. G., Rr. A. dhe 14 vjeç i paidentifikuar, ndërsa H. A. mbijetoi.
 - Civilët e mëposhtëm shqiptarë iu nënshtruan trajtimit çnjerëzor dhe plaçkitjes gjatë sulmit: B. G., Sh. G. dhe M. G..
 - Pas mbërritjes në qytetin e V. ndërmjet 2-3 majit 1999, mijëra Shqiptarë të Kosovës në këtë kolonë u ndaluan nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë në kooperativën bujqësore pranë qytetit të V.
 - Në mes të 3-4 majit 1999, sa ishin duke u mbajtur atje, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në kooperativën bujqësore në këtë kohë, kryesisht të përbërë nga policë dhe policë rezervë nga V., i ndanë burrat Shqiptarë të Kosovës të moshës ushtarake nga gratë, fëmijët dhe të moshuarit .
 - Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i transportuan qindra Shqiptarë të Kosovës të moshës ushtarake nga kooperativa bujqësore në një burg në fshatin S., komuna e V.
 - Pas mbërritjes në burgun e S. dhe gjatë disa javëve të ndalimit në kushte çnjerëzore, shumë nga këta shqiptarë të Kosovës, si dhe të tjerë të ndaluar në operacione të tjera nga policia S., iu nënshtruan rrahjeve dhe trajtimeve çnjerëzore, pas të cilave disa u liruan dhe të detyruar të kalojnë kufirin me Shqipërinë. Gjatë periudhës së

paraburgimit ata u ruajtën jo vetëm nga oficerët korrektues, por edhe nga Policia dhe/ose rezervistët e Policisë nga V.

- Z. V. kishte punuar para luftës si nëpunës në Gjykatën Komunale të V. Gjatë luftës ai ishte përfshirë si polic rezervë. Ai kishte punuar në burgun e S. në Kosovë brenda periudhës prej 2 maj deri në fillim të qershorit 1999.
- Në kuadër të periudhës kohore prej 2 majit dhe fillimit të qershorit 1999, personat e mëposhtëm u burgosën në burgun e S.: S. K., B. F., S. G., S. G., M. U., G. H., F. P., B. M., Sh. M., Sh. B., S. H., A. O., I. F., D. F. dhe S. O., S. Rr. dhe R. A.
- Me ardhjen e tyre në S., shumë të burgosur nuk kishin marrë ushqim ose ujë për tri deri katër ditë.
- Kushtet në S. ishin të këqija. Të burgosurit mbaheshin me qindra në një dhomë që ishte shumë e vogël për t'i mbajtur ata si duhet. Nuk kishte shtretër për të fjetur, si rezultat i së cilës të burgosurit flinin në dyshtemenë e betonit, nëse kishte hapësirë për t'u shtrirë.
- Kur më në fund u lejuan të shkojnë në kantinën e burgut për ushqim, shumë të burgosur u rrahën nga rojat të cilët do të rreshtoheshin para hyrjes. Disa të burgosur nuk pranuan të merrnin ushqim për shkak të frikës së rrahjes.
- Të burgosurve u ishte ndaluar të mbaronin ushqimet e tyre në restorantin e burgut, për shkak të kohës së pamjaftueshme për të ngrënë ushqimin dhe për t'u larguar nga kantina nga personat përgjegjës për ruajtjen e të burgosurve. Z. V. ishte një nga ata persona. S. K., Sh. B. dhe G. H. ishin ndër viktimat që i'u nënshtruan këtyre masave të frikësimit.
- Z. V. i rrahu shumë rëndë disa të burgosur, ndër të cilët B. F., S. G., S. G., M. U., F. P., B. M., Sh. M., Sh. B., S. H., A. O., I. F., D. F. dhe S. O., S. Rr. dhe R. A.
- Rrahja e atyre të burgosurve u zhvillua jashtë ndërtesës ku ishin duke u mbajtur të burgosurit. Z. V. përdori një shkop dhe një bisht fshese për të goditur viktimat e tij në duart dhe nëse ata do të lëviznin duart gjatë rrahjes, ai i godiste në kokë ose në krahët e tyre.
- Pas rrahjeve, duart e viktimave ishin të enjtura dhe - meqë kishin ndonjë kujdes mjekësor, me përjashtim të S. G. - ata i mbështillnin duart në çorape që ishin zhytura në ujë. Shumë viktima ende vuajnë nga pasojat e këtyre rrahjeve.
- Z. V. ishte mizor në sjelljet e tij ndaj viktimave.

E.2. Përmbledhje e fakteve të paprovuara

62. Gjykata i shqyrtoi faktet relevante në vijim si të paprovuara përtej dyshimit të arsyeshëm.
- Nuk mund të vërtetohet se Z. V. mes 2 majit 1999 dhe 3 majit 1999 në cilësinë e tij si polic rezervë nga Stacioni Policor i V., me përgjegjësi personale dhe/ose duke vepruar në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të forcave të ndryshme Serbe (duke përfshirë Policinë rezervë dhe paramilitarët) të ketë marrë pjesë në sulm ndaj popullatës civile etnike Shqiptare që udhëtonte në një kolonë mes S. së E. dhe S. së P..
 - Nuk mund të vërtetohet se Z. V. mban përgjegjësi, qoftë drejtpërdrejt ose në bashkëkryerje me të tjerët,
 - në vrasjen e: E. M., Xh. M., F. (A) G., E. R., A. B., B. G., A. G., Rr. A. dhe një djali 14 vjeç të pidentifikuar;
 - në plagosjen e H. A.;
 - në trajtimin çnjerëzor të B. G., Sh. G. dhe M. G.
 - Nuk mund të vërtetohet se i pandehuri Z. V. të ketë marrë pjesë në ndalimin e paligjshëm të një numri të madh të popullatës civile etnike Shqiptare në Burgun në S., rajoni i M., duke përfshirë S. K., B. F., M. U. F. P., B. M., Sh. B., G. H., A. O., S. O., I. F., D. F., S. G., S. G., S. H., Sh. M., S. Rr., R. A..

E.3. Analiza / vlerësimi i provave dhe vlera provuese

- **AKUZAT I**
63. Lidhur me sulmin ndaj kolonës që udhëtonte në rrugën "S. G.", përveç provave të dëgjua në Gjykatë, Trupi Gjykues mori njoftimin gjyqësor për gjetjet e Dhomave Gjyqësore të Tribunalit të Hagës në rastin e M. et Alia⁶.
64. Trupi Gjykues Gjyqësore konkludoi se:
- "... bazuar në urdhrat ushtarake dhe raportet luftarake, më 2 maj 1999 forcat e MPB-së dhe të UJ-së u angazhuan në një veprim në zonën përreth fshatrave S., C., S. e P. dhe S. e E., që kishte një prani të fortë të UÇK-së. Veprimi rezultoi në rënien e UÇK-së. Si rezultat i konfliktit, u krijua një kolonë e rreth 30,000 Shqiptarëve të Kosovës, duke lëvizur drejt jugut të komunës. Këta njerëz lanë shtëpitë e tyre të paktën pjesërisht për shkak të udhëzimeve ose urdhrave nga UÇK-ja. Pasi ata u larguan, lëvizja e tyre kontrollohej nga MPB, e cila gjithashtu i plaçkiti dhe keqtrajtoi"⁷.*
65. Dhe përsëri:

⁶ Ibid numër 5.

⁷ Ibid, Vëllimi 2 nga 4, par 796.

*"Dhoma e konsideron se kolona ishte përbërë kryesisht nga civilë, edhe nëse kishte pasur ndonjë pjesëtarë të UÇK-së të pranishëm apo afër"*⁸.

66. Edhe pse Dëshmitarët në deklaratat e tyre përsëritën në detaje ngjarjet e sulmit në kolonë, Trupi Gjykes nuk e konsideron të nevojshme një analizë të plotë të këtyre përshkrimeve në dritën e gjetjeve të elaboruara tashmë nga Tribunali i Hagës. Trupi Gjykes vetëm vë në dukje se provat e dala në Gjykatë janë në përputhje me të gjeturat e Tribunalit të Hagës.
67. Trupi Gjykes pastaj duhej të vlerësonte veprimet individuale të pretenduara të kryera nga i pandehuri bazuar në provat e paraqitura gjatë rrjedhës së shqyrtimit kryesor.
68. Të gjithë Dëshmitarët e dëgjuar gjatë shqyrtimit kryesor ishin dëgjuar gjatë fazës së paraprake nga Policia, duke përfshirë Njësinë për Hetimit e Krimeve të Luftës në EULEX-it (NjHKO) ose Prokurorinë.
69. Gjatë Gjykimit aktual, Trupi Gjykes vuri në dukje se, lidhur me Pikën I të Aktakuzës, dëshmitarët e njëjtë duket se kanë zbutur përshkrimet e tyre të mizorive që kishin deklaruar më herët se kishin kaluar dhe/ose rolin që i pandehuri ka luajtur aty. Asnjë shpjegim i kënaqshëm nuk është dhënë për këto dallime, dhe as Trupi Gjykes nuk ka gjetur asnjë tregues konkret të presionit mbi dëshmitarët, qoftë nga ana e Prokurorisë gjatë deklarimeve të tyre të mëparshme ose nga Mbrojtja përpara ose gjatë shqyrtimit kryesor.
70. Është një fakt i njohur që me kalimin e kohës edhe kujtimet më të dhimbshme, kur nuk rifreskohen rregullisht, tentojnë të zbehet. Megjithatë, rrëfimet e dhëna në Gjykatë nga Dëshmitarët dhe mospërputhjet e lidhura, çoftë me deklaratimet e tyre të dhëna më parë ose me deklaratimet e dhëna në Gjykatë nga Dëshmitarët tjerë, përbënin dyshime serioze për identifikimin e të pandehurit gjatë kohës kritike, praninë e tij në vendin e krimit dhe veprimet e tij të supozuara.

Vrasja e E. M., Xh. M., E. R. dhe F. (A) G.

71. Vrasja e E. M., Xh. M., E. R. dhe F. (A) G. u lidh nga dëshmitari N. G.⁹.
72. N. G. ishte në kolonën e S. në një rimorkio me vëllezërit e tij Sh. G. dhe M. G., ndërsa vëllai tjetër i tij F. G. voziste traktorin që po e tërhiqte këtë rimorkio. Kushëriri i tyre F. (A.) G. po e voziste traktorin përpara tyre.
73. Pesë persona iu afruan: tre persona e ndaluan traktorin dhe dy vazhduan. Nga këta tre persona dëshmitari e njohu Z. V. dhe një person tjetër të quajtur A. K. Z. V. kishte veshur rroba policore, ngjyrë të kaltër, me mbishkrimin "milicija". Ai e kishte veshur një kapelë dhe e mbante një pushkë automatike.

⁸ *Ibid*, par 797.

⁹ N. G., procesverbali i seancës 4 tetor 2017, faqet 5 deri 56.

74. Dëshmitari e njihje Z. V. sepse ata të dy punonin për të njëjtën kompani (Kompania e Ndërtimit të Kosovës) dhe kishin komunikim të përditshëm. V. më vonë ka shkuar për të punuar në Gjykatën Komunale në V. Kur Z. V. u bë polic, dëshmitari e takoi edhe në rrugë.
75. Sipas N. G., Z. V. dhe A. K. i detyruan E. M. dhe Xh. M. të zbresin nga rimorkio, si dhe E. R. dhe A. B. Ata u ekzekutuan në një distancë prej rreth 3 metra. Dëshmitari nuk mund të thotë se cili nga të dy (Z. V. apo A. K.) e ka kryer ekzekutimin. Pas kësaj, Z. V., A. K. dhe një person i tretë me emrin D. S. e morën F. (A) G. dhe e ekzekutuan atë. Për shkak të errësirës dëshmitari nuk mund të tregonte se cili e bëri.
76. Vëllezërit e tij **Sh. G.**¹⁰ dhe **M. G.**¹¹, të cilët gjithashtu u dëgjuan si dëshmitarë në Gjykatë, fare nuk e përmendën se i kanë parë këto vrasje. Nuk është dhënë asnjë shpjegim, ose mund të gjendet, se si është e mundur që dy dëshmitarë, të cilët janë të pranishëm në të njëjtën ngjarje në vendin e saktë të njëjtë, nuk i kanë parë këto ekzekutime, ekzekutimet që ndodhën në një distancë prej 3 metrash.
77. Gjykata gjithashtu vëren se N. G., pasi u dëgjua si dëshmitar më 12 shtator 2004, deklaroi se nuk e dinte se kush i ka kryer vrasjen e E. R. dhe F. (A) G.
78. Për këtë arsye, megjithëse Trupi Gjykues gjen të provuar vrasjet e E. M., Xh. M., E. R. dhe F. (A) G. si një fakt i padiskutueshëm i konfirmuar nga autopsitë e dhëna në dosjen e lëndës¹², Gjykata konstaton se deklarata e N. G. nuk është e besueshme sa i përket përfshirjes së të Pandehurit në këto vrasje, pasi nuk mund të vërtetohet nga dëshmitarë të pranishëm në të njëjtën kohë në të njëjtin vend dhe ndryshoi nga deklarata e tij e mëparshme, pa pohime shtesë që mund të zbusin devijimin.
79. Gjithashtu skicat e bëra nga dëshmitari N. G. në lidhje me vrasjet (**provat materiale 1, 3 dhe 4**) nuk ishin në dobi të Gjykatës pasi nuk u vërtetuan nga skica të ngjashme nga Dëshmitarët e tjerë.

Vrasja e A. B.

80. Vrasja e A. B. u lidh nga dëshmitarët **N. G.** dhe **Sh. G.**
81. N. G. thotë se Z. V. dhe A. K. shkuan te traktorët e familjeve R. dhe B. dhe i morën E. R. dhe A. B. Nëna e A. i luste, duke u thënë atyre se ai u martua atë ditë, meqë rast autorët i'u përgjigjën në gjuhën S. se ata do të organizonin një martesë për të edhe një herë atë natë. Z. V. e vrau njërin prej tyre dhe A. K. tjetrin. Ata i vendosën pushkët e tyre ndaj trupave të viktimave dhe i qëlluan.
82. **Sh. G.**¹³ deklaroi se si e pa Sh. B. duke u lutur të mos e vrisnin djalin e tij (A. B.) sepse ai ishte martuar atë ditë, me ç'rast dëshmitari Sh. G. e dëgjoi si përgjigje "dhe

¹⁰ Sh. G., procesverbali i seancës 9 nëntor 2017, faqet 3 deri 28.

¹¹ M. G., procesverbali i seancës 17 nëntor 2017, faqet 3 deri 26.

¹² Shih Regjistratorët e EULEX-it V dhe Va të paraqitur më 17 prill 2018.

¹³ Sh. G., procesverbali i seancës 28 shtator 2017, faqet 34 deri 48.

tani do të festojmë" dhe pastaj 3 apo 4 persona e vendosën atë anash rrugës dhe e ekzekutuan.

83. Megjithatë, aty ku N. G. specifikisht i përmend dy burra (me emër), Sh. G. përmend praninë e tre ose katër burrave, pa qenë në gjendje t'i identifikojë ata në atë kohë, pasi, siç thuhet nga Dëshmitari, 'ishte e pamundur t'i njohësh ata sepse shumica e tyre mbanin maska dhe gjithashtu ishte errësirë'.
84. Përkundër faktit se Sh. G. deklaroi se pas luftës atij i ishte thënë se një nga autorët ka punuar në fabrikën "E.", fakti që ai dëshmoi se sulmuesit kryesisht kishin maska dhe ishte errësirë, përbën dyshime për besueshmërinë e mundësisë së njohjes së autorëve dhe, rrjedhimisht, edhe njohjes së dëshmitarëve të tjerë.
85. Veç kësaj, vëllai i të dy dëshmitarëve, **M. G.**, nuk e përmendi fare se e ka parë këtë vrasje. Asnjë shpjegim nuk u dha, ose nuk mund të gjendet, se si është e mundur që një dëshmitar tjetër, i cili është i pranishëm në të njëjtën ngjarje në të njëjtin vend, nuk e ka parë këtë ekzekutim që u krye në një distancë prej 3 metrash.
86. Gjykata gjithashtu e përsëritë atë që u përmend më lartë, atë se N. G., pasi u dëgjua si dëshmitar më 12 shtator 2004, deklaroi se nuk e dinte se kush i kreu disa vrasje, përfshirë atë të A. B.
87. Për këtë arsye, megjithëse Trupi Gjykes konfirmon vrasjen e A. B. si një fakt të padiskutueshëm i pohuar nga dëshmitarë të ndryshëm dhe konfirmuar nga autopsia dhe raporte të tjera të dhëna në dosjen e lëndës¹⁴, Gjykata e gjen deklaratën e N. G., ku bëhet fjalë për identifikimin e Z. V. si një nga dy autorët, e cila deklaratë në atë aspekt nuk vërtetohet nga dëshmitarë të pranishëm në të njëjtën kohë në të njëjtin vend, si jo të besueshme.

Vrasja e një djali të pidentifikuar 14 vjeçar

88. Vrasja e një djali të pidentifikuar 14 vjeçar ishte treguar nga dëshmitarët **N. G.**, **Sh. G.** dhe **M. G.**
89. N. G. tha se një djalë bile as 20 vjeçar u përpoq ta shpëtonte duke lëvizur në mes të traktorit të dëshmitarit dhe traktorit të familjes B/R, duke u zotuar se ishte i ri. Ata që po e përgatisnin ekzekutimin e E. M., Xh. M., E. R. dhe F. (A) G. vrapuan pas këtij djaloshi. Gjegjesisht, Z. V. dhe A. K. vrapuan pas djaloshit, dhe me një rafal të shtënash e bënë që të binte në tokë. Pas rënies së djalit ata e hargjuan tërësisht një rafal.
90. Sh. G. deklaroi se Z. V. dhe djali ishin përballë tij, në mes të dy traktorëve. E gjitha ndodhi në një distancë prej rreth 2 apo 3 metra nga dëshmitari. Djali po ikte nga policët e tjerë dhe djali e preku armën ose bërrylin e Z. V., pas së cilës Z. V. e kapi djalin për fyti ose goje duke i thënë "po vrapon, a po ikën". Djali i tha 7-8 herë "ju lutem mos më vrisni sepse jam vetëm 14 vjeç". Z. V. e le djalin të dilte në një fushë,

¹⁴ Shih Regjistratorët e EULEX-it V dhe Va të paraqitur më 17 prill 2018.

djali filloi të vraponte, mbi të cilën Z. V. qëlloi me një rafal të shtënash. Djali ngriti dorën e tij, ra në tokë. Kur Z. V. iu afrua djalit, e gjuajti një të shtënë të vetme dhe e goditi atë në kokë. Dëshmitari më vonë e kuptoi se djali ishte nga fshati B.

91. M. G. pohon se një polic me emrin K. ishte duke e ndjekur një djalë të ri. Gjatë ikjes ai vrapoi te Z. V., i cili e rrëmbeu djalin pas kokës dhe e dërgoi atë 3 deri 5 metra larg rrugës, dhe djali u shtri në tokë dhe plumba u qëlluan mbi të dhe ai u vra .Rreth 3 apo 4 plumba e përshkruan. Fëmija qau "mos më gjuaj, sepse nuk jam bile as 14 vjeç", deri sa ishte duke u shtyrë nga rruga, pak para se të qëllohej.
92. Gjykata thekson se, siç është thënë më lart, deklaratat e N. G. ngren shumë dyshime lidhur me besueshmërinë e saj dhe prandaj nuk mund të mbështetet nga Gjykata përderisa nuk mbështetet në mënyra të tjera.
93. Në rastin në fjalë, dy dëshmitarët e tjerë që dëshmuar për këtë vrasje dhanë versione të ndryshme të rrjedhës së ngjarjeve. Ku N. G. përmend se si Z. V. dhe A. K. vrapuan pas djalit, M. G. deklaroi se një polic me emrin K. po e ndiqte djalin, i cili vrapoi drejt Z. V., pas së cilës Z. V. e mori djalin me vete dhe vrau. Sh. G. nuk e përmend A. K., por tregon se si djali po ikte nga "oficerët e tjerë të policisë".
94. Edhe në mënyrën se si djali u vra, deklaratat e dëshmitarëve nuk e vërtetojnë. Ku N. G. tregon se si Z. V. dhe A. K. e bënë djalin të binte në tokë me të shtëna të përsëritura dhe si e shkrepën një të shtënë të tërë pasi ai ra, Sh. gjithashtu përmend një shkrepje, por vetëm nga Z. dhe pas kësaj një të shtënë në kokën e djalit. M. G. flet vetëm për "plumbat që u qëlluan mbi të", rreth 3 ose 4 plumba kaluan përtej. Këto tre deklarime të vrasjes së djalit ndryshojnë në një mënyrë të tillë që kontrolli i mjekësisë ligjore në trupin e djalit është më se i rëndësishëm.
95. Fatkeqësisht, shkaku i vdekjes së djalit nuk mund të vërtetohet, pasi që trupi i tij nuk u identifikua asnjëherë, duke e bërë të pamundur hulumtimin e mjekësisë ligjore.
96. Dëshmitarët gjithashtu japin deklarata të ndryshme për kryerësit: ku N. G. e identifikoi Z. V. dhe A. K. si bashkëkryerës, Sh. G. dhe M. G. e identifikojnë vetëm Z. V. si kryerësin e vrasjes.
97. Për më tepër, skicat e vizatuara nga dëshmitarët në lidhje me vrasjen (provat materiale 2, 7 dhe 8) dallojnë nga njëra-tjetra për sa i përket vendndodhjes së kryerësve dhe vrasjes së djalit.
98. Për më tepër, vëllai i dëshmitarëve Sh. G., i cili u dëgjua edhe si dëshmitar në Gjykatë, nuk përmendi se e kishte parë këtë vrasje. Asnjë shpjegim nuk është dhënë apo mund të gjendet, se si është e mundur që ky dëshmitar, i cili është i pranishëm në të njëjtën ngjarje në të njëjtin vend, nuk i ka parë këto ekzekutime që ndodhën në një distancë prej 3 metrash.
99. Për këtë arsye, edhe pse Trupi Gjykses e konstatoi vrasjen e një djali 14 vjeçar të paidentifikuar si një fakt të padiskutueshëm të dëshmuar nga disa dëshmitarë siç është shpjeguar më lart, Gjykata nuk mund të përcaktojë përtej dyshimit të arsyeshëm se si ky djalë 14 vjeç u vra dhe nga kush, sepse deklaratat e dëshmitarëve për disa pika të rëndësishme nuk e vërtetojnë këtë.

Vrasja e Rr. A. dhe vrasja në tentativë e H. A.

100. Vrasja e Rr. A. dhe vrasja në tentativë e H. A. u dëshmuar nga dëshmitarët **B. A., B. A. dhe H. A.**

101. Gjatë vlerësimit të fakteve, Gjykata e konsideron deklaratën e H. A. si më të besueshme, sepse ai ishte njëri nga personat që u sulmua dhe e di më së miri se çfarë i ndodhi atij.

102. Më 2 maj 1999, dëshmitari H. A.¹⁵ u largua nga C. në drejtim të S. së E., B., B. dhe Rr. A. ishin në të njëjtin traktor me dëshmitarin.

103. Dëshmitari po ngiste. Rr. ishte në mes të rimorkios dhe traktorit, B. dhe B. ishin në rimorkio. B. ishte shtrirë në traktor. Tre persona me rripa të municionit iu afruan traktorit në afërsi të S. së P. Dy prej tyre erdhën te dëshmitari dhe e shanë. Njëri prej tyre i tha të zbriste dhe e kapi. Rr. gjithashtu u urdhërua që të zbriste.

104. Njeriu që e kapi mbante një maskë dhe i tha që të dorëzonte paratë e tij, që ishin 100 marka gjermane. Ky person e vuri tytën e pushkës automatike drejt shpatullës së tij dhe i tha që të kthehej dhe të ecë drejt rrjedhës së ujit. Dëshmitari u kthye prapa dhe e dëgjoi një të shtënë dhe u godit në ijë. Ai ra në shpinë. R. ra në tokë pa shenja jete. Pas 10 minutash deri në gjysmë ore, këmbët e tij u ngritën nga toka, për shkak të plumbit, ai mund të shihte vrima në këmbën e tij. Njeriu që e kapi dhe e qëllloi ishte i gjatë dhe kishte një maskë, duke e bërë të pamundur që dëshmitari ta njohë. Ai ishte trupmadh, jo i trashë. Dëshmitari tha se e dëgjoi zërin e këtij njeriu kur ishte i shtrirë në tokë. Ai dëgjoi që njerëzit e tjerë e quanin këtë person “Z.” Dëshmitari më tej shtoi se ai nuk e pa Z. V. në S. gjatë asaj dite.

105. Deklarata e B. A. dhe B. A. nuk e mbështesin deklaratën e H. A. për pikat kyçe të saj.

106. **B. A.** deklaroi se po udhëtonte në kolonën nga S. e E., përmes S. së P. në V.¹⁶ Z. V. e kapi Rr. A. nga krahu dhe e tërhoqi poshtë dhe gjithashtu i tha H. A. që ta ndiqte atë. Z. V. i largoi ata 2 metra larg nga rimorkio. Viktimat i dhanë para Z. V. dhe u kthyen pastaj në drejtim të lumit.

107. Z. V. shtiu me armë zjarri dhe të dytë ranë në tokë. Pas kësaj, një tjetër e shtënë u gjuajt në drejtim të H. dhe Rr. A., pas së cilës këmba e H. u kërceu lart. Rr. ishte i vdekur, ai u qëllua në kraharor, por H. A. ishte ende gjallë.

108. Z. V. kishte veshur uniformë policore, me arna si tigër dhe ishte ngjyrë blu me ngjyrë gri të errët. Në krah ishin simbole të policisë. Ai kishte një pushkë automatike, një AK-47. Ai kishte vënë një kapelë të ngjashme me kapelën “N.” pa rreth. Ai ishte rreth 2 metra i gjatë, 27/28 deri në 30 vjeç, flokë të zinj. Dëshmitari deklaroi se mund të shihte fytyrën e Z. V. nga shumë afër. Dëshmitari e njeh Z. V. nga V. dhe shtoi se shpesh e takonte kur shkonte në shkollë dhe se Z. V. punonte si oficer policie. Në vitin 1996 dëshmitari e pa atë në gjykatë me rroba civile.

¹⁵ H. A., procesverbali i 11 tetorit 2017, faqet 33 deri 50.

¹⁶ B. A., procesverbali i 17 nëntorit 2017, faqet 27 deri 48.

109. Dëshmitari **B. A.** dëshmoi se ai u plagos me armë zjarri më 2 maj 1999¹⁷. Ditën e nesërme dëshmitari ishte në rimorkio në konvojin nga S. e E. përmes S. së P. drejt V.

110. Xhaxhai i tij, H. A. po e ngiste traktorin. Vëllai i tij Rr. gjithashtu po e ngiste traktorin. Kushëriri i tij B. A. ishte me të në rimorkio. Dëshmitari ishte i shtrirë në traktor, siç deklarohet edhe nga dëshmitari H. A.

111. Kur po afroreshin në S. të P. ata u ndaluan nga policia dhe ushtria serbe. Xhaxhai dhe vëllai i tij u morën nga traktori dhe u vendosën në anën e majtë të rrugës. Atyre iu kërkua para. Ata u kthyen me shpinë drejt rrugës. Pastaj u qëlluan menjëherë. Së pari vëllai i tij ra në tokë, pastaj xhaxhai i tij.

112. Ishin tre ose katër burra të cilët iu afruan traktorit, njëri prej tyre ishte Z. V. Ata ishin veshur me rroba policore dhe ishin të armatosur me kallashnikovë. Dëshmitari ishte ulur në rimorkio dhe kishte një pamje të qartë. Ishte Z. ai i cili e tërhoqi R. nga traktori dhe e vrau atë. Ai u qëllua me një kallashnikov. Fillimisht ata mendonin se të dy u vranë, por xhaxhai i tij vetëm ishte plagosur.

113. Dëshmitari u mbulua me një batanije, në mënyrë që ai mos të vërehej pasi ai dhe të afërmit e tij kishin frikë se nëse sulmuesit do të kishin parë se ai ishte plagosur, ata do të kishin menduar se ai kishte qenë i angazhuar në konflikt.

114. Megjithëse dëshmitari deklaroi se ende mund të shihte edhe pse ishte i mbuluar, Trupi Gjykues nuk është i bindur për besueshmërinë e deklaratës së tij edhe në aspektin e mospërputhjeve të theksuara më lart me viktimën kryesore të veprimeve në fjalë, përkatësisht H. A.

115. H. A., viktima e drejtpërdrejtë, dëshmoi se si personi që kishte shtënë në të ishte me maskë, prandaj nuk i konfirmonte rrëfimet e dy dëshmitarëve të tjerë.

116. Për këto arsye, edhe pse Trupi Gjykues e konstaton të vërtetuar vrasjen e Rr. A. si një fakt të padiskutueshëm nga dëshmitarë të ndryshëm dhe të konfirmuar nga autopsia dhe raporte të tjera të dhëna në dosjen e lëndës¹⁸, dhe gjithashtu konstaton vrasjen në tentativë të H. A. siç dëshmohet më lart, në të njëjtën kohë divergjenca midis deklaratimit të H. A. dhe dëshmitarëve të tjerë të kombinuar me faktin se dy dëshmitarët e tjerë nuk dëshmuan më parë mbi identitetin e të pandehurit, bëri që Gjykata të theksoj që deklaratat e B. A. dhe B.A. nuk mund të mbështeten kur bëhet fjalë për identifikimin e Z. V. si kryerës i të shtënave.

Vrasja e B. (B) G. dhe A. G.

117. Dëshmitari i vetëm që jep një deklaratë për vrasjen e B. (B) G. dhe A. G. është **I. P.**¹⁹. Dëshmitari ishte me familjen e tij në një traktor. Pesë burra me rroba të zeza me kapele dhe shirita të kuq iu afruan traktorit të tij. Z. V. ishte njëri prej tyre. Ai e njihnte Z. V. nga V., ku të gjithë e njihnin njëri-tjetrin. Ai pa që Z. V. e vrau B. B. G. Ai u largua rreth tre metra nga

¹⁷ Bashkim Ademi, procesverbali i 11 tetorit 2017, faqet 3 deri 33.

¹⁸ Shih regjistrorët e EULEX-it V dhe Va të paraqitur më 17 prill 2018.

¹⁹ I. P., procesverbali i 16 tetorit 2017, faqet 5 deri 34.

traktori i dëshmitarit dhe një tjetër traktor ishte atje. Z. V. pastaj e mori nga traktori B. B. G. dhe e vrau atë.

118. Dëshmitari gjithashtu deklaroi se ky grup njerëzish e vrau vëllain e B., A. G., por dëshmitari nuk e pa se kush e qëllloi atë.

119. Pasi që ky rrëfim i ngjarjeve (ose më mirë, disa kujtime të ngjarjeve që dëshmitari i ka dhënë) nuk është vërtetuar me ndonjë provë tjetër që drejton tek Z. V., Gjykata u përpoq ta vlerësojë atë në aspektin e deklaratave të dhëna më parë nga dëshmitarët.

120. Gjykata thekson se I. P., pasi u dëgjua si dëshmitar më 4 nëntor 2005, deklaroi se 3 policë serbë kishin arritur; prej tyre ai e njohte D. K., A. K. dhe një burrë të quajtur “T.” nga fshati B.. D. K. ishte ai që e vrau B. (B) G.. Dëshmitari nuk e përmendi fare emrin e Z. V.

121. Gjykata gjithashtu thekson se i njëjti dëshmitar, pasi u dëgjua më 16 prill 2014, deklaroi se i njohu disa serbë me emrat V., D. J., T., A. K. dhe D. K.. Sipas dëshmitarit, B. (B) G. u qëllua nga A. K.. Përsëri, dëshmitari nuk përmendi fare emrin e Z. V.

122. Për këto arsye, edhe pse Trupi Gjykses gjen të vërtetuar vrasjen e B. (B) G. dhe A. G. si padyshim të konfirmuar nga autopsia dhe raporte të tjera të paraqitura në dosjen e lëndës²⁰, Gjykata e konsideron dëshminë e I. P. se kush e ka kryer vrasjen e B. (B) G. si jo të besueshme.

123. Deklarata për më tepër nuk i siguron Gjykatës prova që Z. V. e vrau A. G., pasi që dëshmitari deklaroi se nuk e ka parë se kush e ka vrarë.

Rrahjet e Sh. G. dhe M. G.

124. Për shkak të pamundësisë së theksuar më lart për tu mbështetur në deklaratat e dëshmitarëve N. G., Sh. G. dhe M. G. në lidhje me përfshirjen e të pandehurit në veprimet kritike, Trupi Gjykses gjithashtu nuk ka mundur të vërtetojë përfshirjen e të pandehurit në rrahjet të cilave ishin nënshtruar dëshmitarët Sh. G. dhe M. G.

Dëshmitarë të tjerë të pabesueshëm

125. **R. M.**²¹ dëshmoi në Gjykatë se si i pandehuri Z. V. ishte midis sulmuesve të konvojit dhe ai e vrau burrin e saj. Megjithatë, besueshmëria e këtij dëshmitari ishte ndikuar rëndë nga ngjarjet që ndodhën në sallën e gjyqit. Përkatesisht, dëshmitari u gjet me një shkrim në pëllëmbën e dorës së saj si vijon: “Z. pesudhe te marke”, e cila u interpretua si “Zoran, 50 marka”. Kur u pyet për këtë, dëshmitari deklaroi se nipi i saj e kishte shkruar këtë në pëllëmbën e saj, pasi ajo ka prirje të harrojë gjëra.

²⁰ Shih regjistrorët e EULEX-it V dhe Va të paraqitur më 17 prill 2018.

²¹ R. M., procesverbali i 28 shtatorit 2017, faqet 3 deri 34.

126. Një ngjarje e tillë ka ndikuar në mënyrë të pashmangshme në besueshmërinë e dëshmitarit dhe së bashku me faktin se dëshmitari nuk e kishte identifikuar më parë të pandehurin, e bënë deklaratën e saj të pabesueshme.

127. **B. G.**²² tregoi ditën e sulmit në konvojin e S. dhe se si ajo ishte objekt i plaçkitjes dhe gjithashtu i rrahjeve nga oficerët e policisë serbe. Megjithëse Trupi Gjykes nuk dyshon në vërtetësinë e rrëfimit të dëshmitarit për ngjarjet tragjike që i ka vuajtur, ai megjithatë dyshon në inkriminimin e të pandehurit Z. V. në këto ngjarje për shkak të arsyeve të mëposhtme.

128. Ndonëse nuk e njohte Z. V., ajo megjithatë arriti që ta identifikonte atë. Në të njëjtën kohë, dëshmitari dëshmoi se si i pandehuri e vinte maskën dhe e hiqte atë vetëm kur ishte duke folur me të. Të gjitha këto elemente e bëjnë deklaratën e dëshmitarit një objekt dyshimi për besueshmërinë e tij.

129. Raporti i policit i marr nga hetuesit e EULEX-it kur ata iu drejtuan së pari dëshmitarit (**prova materiale 9**) nuk ishte përdorur nga Gjykata në vlerësimin e provave të dhëna në gjykim nga dëshmitari, duke konsideruar se kjo deklaratë nuk ishte marr në përputhje me parimin e provave të KPP-së. Sidoqoftë, sikur trupi gjykes të ishte në gjendje të përballte dëshmitarin me këtë deklaratë, do të kishin dalë në pah edhe më shumë mospërputhje në identifikimin e të pandehurit nga dëshmitari.

130. Si i tillë, ky dëshmitar u gjet gjithashtu i pabesueshëm.

• AKUZA III

131. Ndryshe nga Akuza I, Trupi Gjykes gjeti se deklaratat e dhëna nga Dëshmitarët në lidhje me Akuzën III i mundësuan Gjykatës që të vërtetoj ngjarjet që ndodhën në burgun e S. në mes të 3 majit dhe fillimit të qershorit 1999 dhe përfshirjen e të pandehurit në këto ngjarje.

132. Siç është shpjeguar më poshtë, dëshmitarët ishin konsekuent dhe e konfirmuan njëri-tjetrin në deklaratimet rreth arritjes së tyre në S.

133. Disa prej tyre treguan se, pas marrjes në pyetje pas mbërritjes në burg, iu kërkua të nënshkruanin një deklaratë që dëshmonte se ishin anëtarë të UÇK-së edhe pse ata kishin mohuar qartazi se nuk ishin luftëtarë të UÇK-së dhe siç dëshmohej nga dëshmitarët, ua kishin bërë me dije personave që o i merrnin në pyetje se nuk ishin anëtarë të UÇK-së.

134. Dëshmitarët deklaruan se si gjatë ditëve e para nuk morën fare ushqim dhe vetëm një sasi të kufizuar uji.

135. Pastaj, ata treguan mbi vendosjen e tyre në sallën e TV-së, disa prej tyre menjëherë pas marrjes në pyetje, dhe të tjerët pas disa ditësh që u mbajtën në dhoma të tjera, shpesh më të vogla. Sidoqoftë, nuk kishte asnjë shtrat në asnjërën nga dhomat ku po mbaheshin.

²² B. G., procesverbali i 7 dhjetorit 2017.

136. Dëshmitarët dëshmuar për kushtet e këqija të burgimit që duhej të duronin. Përveç që nuk ishin siguruar me shtretër, ata u shtrydhën së bashku me qindra njerëz në sallën e TV-së për disa ditë, në kushte të këqija higjienike dhe me qasje në ushqim të kushtëzuar nga rrethanat që do të sqarohen më poshtë.

137. Trupi gjykues mundi të dallojë dy grupe të ngjarjeve që lidhen me veprimet e kryera nga i pandehuri. Përkatësisht, rrahjet dhe veprimet e ndërlidhura të kryera nga i pandehuri kundër dëshmitarëve dhe palëve të tjera të dëmtuara dhe sjelljet kërcënuese të kryera në kantinë derisa viktimat po përpiqeshin të hanin ushqimet e tyre.

138. Dëshmitarët ishin konsekuent në rrëfimet e tyre mbi rrjedhën e ngjarjeve dhe u konstatuan të besueshëm dhe serioz. Ata e vërtetuan njëri-tjetrin madje edhe në detajet e mënyrës së kryerjes së rrahjeve dhe në përshkrimin e karakteristikave të tyre. Megjithëse dolën në pah disa mospërputhje, ato nuk ishin kaq thelbësore apo të jashtëzakonshme për të paraqitur dyshime për përfshirjen e të pandehurit në veprimet e akuzuara. Për më tepër, Trupi Gjykues gjithashtu gjeti deklaratat e dëshmitarëve të drejta dhe jo të ekzagjeruar, përveç disa përjashtimeve të analizuar më poshtë, të cilat megjithatë nuk u konsideruan si një ndikim thelbësor në vlerësimin e përgjithshëm.

Njoftimi gjyqësor

139. Trupi gjykues mori njoftimin gjyqësor për faktet e ngritura nga TPNJ në rastin M. në lidhje me ndalimin e shqiptarëve në objektet e burgut të S.

140. Dhomat Gjyqësore të TPNJ-së kanë gjetur se:

“... ndërmjet 1 dhe 3 majit forcat e MUP-it e ndanë kolonën në tre grupe. Grupi i parë, i përbërë nga gra, fëmijë dhe të moshuar që kishin automjete, u dërgua në Shqipëri; grupi i dytë, i përbërë nga gra, fëmijë dhe të moshuar që nuk kishin mjete transporti, u dërguan në fshatrat e afërt, mes tyre K. dhe D.; ndërsa grupi i tretë, që përmbante kryesisht meshkuj të moshës ushtarake, u dërgua në burgun e S., ku u arrestuan dhe u keqtrajtuat. Pas arrestimit në kushte të mjerueshme për rreth tre javë, të burgosurit u dërguan në kufirin shqiptar, ku u detyruan të dorëzonin dokumentet e tyre të identifikimit dhe të kalonin në Shqipëri”²³.

Fakte të tjera të padiskutueshme

141. Është fakt i pakontestueshëm se i pandehuri Z. V. punonte në Gjykatën Komunale në V. së paku nga viti 1992 në zyrën e pranimit 6, pasi jo vetëm që ky fakt është dëshmuar nga **dëshmitari T. Rr.**²⁴ dhe është vërtetuar nga disa dëshmitarë të tjerë në Gjykatë, siç është elaboruar më poshtë në pjesën për njohjen e të pandehurit, por kjo është konfirmuar edhe nga i pandehuri i njëjtë në procedurat e tjera penale në vazhdim kundër tij dhe për të cilat Gjykata merr njoftimin gjyqësor²⁵.

²³ Shih më lart, numri 5, vëllimi 2 prej 4, para 800

²⁴ T. Rr., procesverbali i 30 nëntorit 2017, faqet 2 -11.

²⁵ Shih deklaratën e dhënë nga i pandehuri në çështjen penale P.nr 67/17 më 15 maj 2018.

142. Për më tepër, duke u bazuar në provat e paraqitura nga Gjykata, përkatësisht prova materiale e TPNJ-së P02335 e administruar gjatë çështjes së Tribunalit të Hagës M. e të tjerë²⁶, të paraqitur në këtë dosje të lëndës më 17 prill 2018 dhe që nuk është kontestuar nga mbrojtja, është e padiskutueshme që i pandehuri Z. V. ishte regjistruar si rezervist i policisë në V. gjatë kohës së konfliktit në Kosovë.

Vlerësimi i deklaratave të Dëshmitarëve

143. Dëshmitari **S. K.** nuk ishte viktimë e drejtpërdrejtë e veprimeve të kryera nga i pandehuri, por ai ishte dëshmitar okular i tyre.

144. Dëshmitari tregoi si më poshtë ngjarjet që ndodhën në burgun e S.²⁷. Më 2 maj 1999, refugjatët që mbërritën në V. u futën në oborrin e K. B.

145. Të nesërmen, burrat u ndanë nga gratë, u vendosën në rimorkio dhe u transportuan në burgun e S. Me të hyrë në burg, ata u detyruan të kalonin nëpër një kordon të burrave të policisë që i goditën mjaft fort me shkopinj bejsbolli dhe shkopinj gome. Ata u burgosën në dhoma të zbrazëta, pa shtretër. Pas 16 majit, të burgosurit e rinj u sollën dhe nuk kishte më vend për tu shtrirë në tokë.

146. Pas mbërritjes së tyre, për tri ditë nuk morën ushqim e as ujë. Duke shikuar nga dritaret mund të shihnin rojet që rrihnin njerëzit. Njerëzit filluan të vdesin nga uria dhe diarreja, sepse uji që më në fund e morën ishte i kontaminuar.

147. Dëshmitari pa se si Z. V. i rrihte njerëzit shumë fort me një shkop gome derisa ata binin në tokë pa ndjenja.

148. Kurdoherë që dëshmitari e shihte Z. V. atje, ai nuk shkonte në kantinë për të ngrënë, sepse ai po i keqtrajtonte njerëzit shumë rëndë. Tre ose katër herë ai e pa Z. V. duke i rrahur njerëzit në kantinë. Ai i rrihte derisa u dilte gjak kur ishin duke pritur në radhë për ushqim. I pandehuri shpesh përdorte një shufër metalike dhe nganjëherë shkopinj prej gome dhe shkopinj bejsbolli për të kryer veprimet e tij.

149. Dëshmitari tregon se si e pa Z. V. çdo ditë në burg, nga 3 maji deri më 23 maj 1999, ose të paktën ndihej si çdo ditë. Z. V. i shoqëronte njerëzit që u dërguan për marrjen në pyetje dhe i rrihte me shkop gome. Dhe në një moment ai do të vinte muzikë me altoparlantë dhe i rrihte njerëzit dhe i nxirrte nga dhomat.

150. Dëshmitari **S. G.** tregoi se²⁸, kur mbërriti në burgun e S., u vendos në një bodrum me 60 deri në 70 burra të tjerë, ku mbetën katër ditë pa ushqim, vetëm pak ujë kishin në dispozicion. Në ditën e pestë njerëzit nga Sh. dhe B. u urdhëruan që të rreshtohen dhe u dërguan në një pavijon tjetër. Dëshmitari nuk ishte pjesë e këtij grupi. Pasi u urdhërua që të dilte jashtë, ai u godit nga një polic në pjesën e pasme të kokës dhe në qafë.

²⁶ Shih më lart, numër 5.

²⁷ S. K., procesverbali i 27 shtatorit 2017, faqet 4 deri 59.

²⁸ S. G., procesverbali i 7 nëntorit 2017, faqet 5 deri 32;

151. Pas dy nate, dëshmitari u soll në sallën e TV-së, ku kishte rreth 500 deri në 600 burra. Nuk kishte vend për t'u shtrirë dhe ishte e mundur vetëm që të ulej.

152. Z. V. po i ruante në ndërrime. Ai ulej jashtë me rojet e tjera dhe ata piqnin dhe pinin birra.

153. Dëshmitari e njihte shumë mirë Z. V., siç është shpjeguar më poshtë dhe Z. V. e njihte dëshmitarin. Në fakt, i pandehuri i tha dëshmitarit se ai e dinte se dëshmitari nuk ishte anëtar i UÇK-së, por ai i kishte dhënë UÇK-së 'pak ndihmë'.

154. I pandehuri pastaj e urdhëroi dëshmitarin të dilte jashtë dhe pasi doli jashtë, i tha atij të zgjaste duart dhe ai i dha shumë goditje, rreth 80 herë, në duart e tij me një shkop gome që përdorej nga policia. Kur dëshmitari u kthye brenda, ai e humbi vetëdijen. Kjo ishte e vetmja kohë kur dëshmitari u rrah nga i pandehuri. Dëshmitari shtoi se kishte marrë trajtim mjekësor në atë rast sapo u kthye brenda ndërtesës së burgut.

155. Dëshmitari dëshmoi se si përpara tij, vëllai i tij S. G. ishte keqtrajtuar gjithashtu nga Z. V. Dëshmitari e pa këtë rrahje brenda nga salla e TV-së, përmes një dritareje. Rrahja ndodhi jashtë, te shkallët. S. G. gjithashtu u godit në duart e tij.

156. Për më tepër, Dëshmitari shtoi se edhe fqinji i tij M. U. ishte keqtrajtuar nga Z. V., menjëherë pas rrahjes së dëshmitarit.

157. Për sa i përket ngjarjeve që ndodhën në kantinë, dëshmitari deklaroi se gjatë ndërrimit të Z. V. njerëzit nuk guxonin të hynin për të ngrënë.

158. Edhe sot dëshmitari nuk mund të ndjejë një pjesë të krahut të tij. Ai u mbajt në S. nga data 3 deri më 22 maj 1999.

159. Dëshmitari S. G.²⁹ deklaroi se shkoi në kooperativën në V. më 2 maj 1999, pas ikjes nga bombardimi i f. S.. Të nesërmen ai u dërgua në burgun e S. me një kamion. Ai u vendos në një pavijon të njohur si "radio TV", salla e TV-së. Ai nuk mori ushqim apo ujë për tre ditë. Pas kësaj ai mori pak bukë të fortë dhe të thatë.

160. Pasi u mor në pyetje ai u godit në duar nga një paramilitar me një dorezë lopatë, si rezultat i së cilës dora e tij u thye. Rojet ishin të veshur me ngjyrë blu të errët.

161. Dëshmitari rikujton se si në një rast, Z. e goditi 30 herë në duar me një shkop. Kur ai e tërhoqi njërën nga duart për shkak të gjakut që dilte nga ajo, Z. e goditi në kokë. Pasi hyri brenda, të paraburgosurit e tjerë i vunë ujë në duar për shkak të plagëve dhe të ënjturave. Ky ishte rasti i vetëm që u rrah nga i pandehuri.

162. Duke vërtetuar atë që u deklarua nga dëshmitari S. G., dëshmitari deklaroi se pas tij, S. vëllai i dëshmitarit, u thirr jashtë. Nëpërmjet një dritare, dëshmitari pa se vëllai i tij S. u rrah nga Z.. Burra të tjerë që rriheshin ishin: S. G., A. G., H. N.

163. Në lidhje me ngjarjet në kantinë dëshmitari pohoi se si ata nuk ishin në gjendje të hanë në qetësi në restorant. Ata rrinin në rresht, një oficer policie do të hynte brenda dhe do të

²⁹ S. G., procesverbali i 14 shkurtit 2018, faqet 2 deri 23.

fillonte numërimin 1, 2, 3 dhe do të bërtiste “dilni jashtë!” Dhe i fundit në rresht kurrë nuk e kishte shansin që të merrte ushqimin.

164. Në fund, gjithashtu ky dëshmitar rikujtoi që kishte parë shishet e birrës të shpërndara jashtë në tokë dhe shtoi se po luheshin këngë nacionaliste serbe.

165. Dëshmitari **M. U.** u dërgua në Burgun e S. më 3 maj³⁰. Ai qëndroi me 16 vetë në një dhomë të vetme për dy ditë e dy net, i ulur në një dysheme nga qeramika. Atij iu dha ushqim në natën e dytë dhe kishte ujë brenda. Ditën e tretë ata u sollën në pavijone dhe u rrahën nga disa njerëz me shkopinj prej druri. Pas dy net qëndrimi në pavijone, pasi u morën në pyetje, ata u sollën në sallën e TV-së. Në një pjesë të sallës kishte ndoshta më shumë se 400 burra.

166. Z. V. ishte një nga burrat që i ruanin në ndërrime 12 orësh. Duke vërtetuar atë që u tha nga S. dhe S. G., dëshmitari dëshmoi se i pandehuri i rrahu dy persona të familjes G. (S. dhe S.) para se ta rrihte atë. Ai ishte i treti në radhë atë ditë.

167. Dëshmitari nuk mund të llogariste goditjet e shkopit, midis 72 dhe 80 godet në duar. Kjo ndodhi në hyrje të korridorit. Ai ishte jashtë dhe të tjerët mund të shihnin ngjarjet nga brenda, sepse kishte një dritare dhe xhami ishte i thyer. Dëshmitari e shënoi këtë pikë vendndodhjeje në **provën materiale 6**. Kur dëshmitari u kthye brenda, Z. V. e goditi atë në kokë me një dorëz të fshesës. Ai nuk mori asnjë trajtim mjekësor në burg.

168. Z. V. gjithashtu i pengoi të burgosurit të hanin ushqimet e tyre. Sapo u shërbehej ushqimi dhe uleshin për të ngrënë, ai e godiste tryezën me shkop dhe do u thoshte ‘lini pjatat’ dhe vetëm disa prej tyre arrinin të vidhnin një copë të vogël të bukës dhe të vënë në xhep dhe ta hanë në dhomat e tyre.

169. Z. po përdorte një shkop druri, një dorëz të fshesës në gjatësi prej gjysmë metri. Ai i rrihte njerëzit për 12 orë derisa ishte në ndërrimin e tij. Ai i rrihte të sapoardhurit. Siç është përmendur edhe nga dëshmitarë të tjerë, gjithashtu ky dëshmitar deklaroi se ata që u rrahën një herë nga i pandehuri nuk u rrahën për herë të dytë.

170. Dëshmitari gjithashtu rikujtoi se i pandehuri luante muzikë nacionaliste dhe anti-shqiptare dhe piqte mish jashtë.

171. **Dëshmitari G. H.** tregoi se si qëndroi në burgun e S. nga data 3 deri më 24 maj 1999³¹. Për 5 ditë dhe 4 net ai nuk ishte furnizuar me ushqim, vetëm me ujë që mori nga tualeti. Ai qëndronte në sallën e TV-së me 400 deri në 500 njerëz.

172. Z. V. ishte njëri nga rezervistët që po kryente sigurimin e të burgosurve dhe mbante uniformën e rezervistit. Dëshmitari nuk u rrah, por ai ishte dëshmitar i rrahjeve të përsëritura, përfshirë rrahjet e kryera nga i pandehuri kundër S. dhe S. G.. Ai shtoi se kur Z. V. po punonte në ndërrimin e tij, ai vetëm u bënte me gisht disa personave dhe u thoshte: “ti, ti dhe ti” i nxirrte jashtë dhe i rrihte dhe do të dëgjoreshin britmat e personave që po rriheshin.

173. Ai dëshmoi për ngjarjet që ndodhën në kantinë. Ushqimi hahej në sallën e ngrënies dhe ata urdhëroheshin të shkonin rreth 100 persona në të njëjtën kohë. Njëri nga të burgosurit

³⁰ M. U., procesverbali i 8 nëntorit 2017, faqet 3 deri 22.

³¹ G. H., procesverbali i 8 nëntorit 2017, faqet 23 deri 36.

duhej të numëronte të burgosurit e tjerë, nëse i lejonte të shkonin 101 persona, personi 101 me radhë do të rrihej ose në mënyrë të ngjashme personi 99 me radhë do të rrihej. Ky rrahje u bë nga rezervistët, ndër të cilët ishte Z. V. Ai gjithashtu i pengonte të burgosurit që të mbaronin ushqimet e tyre, duke u thënë që të ndalonin të hanin dhe të shkonin.

174. **Dëshmitari F. P.** deklaroi se si³² burrat ishin ndarë nga gratë në kooperativën bujqësor në V. dhe burrat dërgoheshin në burgun e S. Dëshmitari qëndroi atje prej 3 deri më 23 maj 1999.

175. Pas marrjes në pyetje, Z. V. e urdhëroi një të burgosur tjetër që ta godiste dëshmitarin. Kur ky person refuzoi, Z. V. filloi të godiste këtë burrë. Dëshmitari e këshilloi të burgosurin tjetër që ta godiste për të shmangur më shumë rrahje nga Z. V. Pas kësaj, i burgosuri e goditi dëshmitarin lehtë mbi sup. Z. V. gjithashtu e urdhëroi dëshmitarin të godiste të burgosurin tjetër. Në fund Z. V. i goditi të dy burrat me shkop të fshesës disa herë.

176. Z. V. i ruante të burgosurit në ndërrime. Ai ishte i veshur me uniformë lara-lara me shenjën “Milicia” dhe një emblemë me PJP, dhe diçka me një shqiponjë të Serbisë dhe kryq. Kur ai ishte në ndërrim, kjo ishte e tmerrshme për të burgosurit. Ai i thërriste njerëzit në bazë të fshatrave të V., për shembull ai do t’i thërriste të gjithë ata që ishin nga S., i rreshtonte dhe i rrihte të gjithë dhe pastaj do të vazhdonte të thërriste fshatra të tjera dhe të rrihte njerëz të tjerë.

177. Në burg nuk kishte fare kujdes mjekësor.

178. Kur shkonin për të ngrënë, Z. V. kurrë nuk i lejonte që të hanin dhe i kthente mbrapsht.

179. Ky dëshmitar gjithashtu rikujtoi se si i pandehuri pinte jashtë ndërsa piqte mish dhe luante këngë nacionaliste.

180. Dëshmitari **B. M.**, pas arritjes së tij në burgun e S.³³, më datë 3 maj, u dërgua në dhomën e TV-së, ku qëndroi për rreth 3 ditë pa ngrënë apo pirë. Pas kësaj, të burgosurit morën një fuçi të madhe uji dhe një copë bukë. Pas pak, rojet filluan t’i jepnin atij dhe të burgosurve të tjerë ushqimin.

181. Z. V. e goditi njëqind herë në pëllëmbë me një shkop. Si rezultat i kësaj duart e tij u mavijosen dhe u ënjtën. Ai u detyrua gjithashtu të grindej me vëllain e tij Sh. M. nga Z. Dëshmitari filloi të kacafytej me vëllain e tij, por Z. V. i tha atij “jo ashtu” dhe e goditi në faqen e majtë dhe në vesh, si rezultat i të cilit veshi i tij për 4 ose 5 ditë pas këtij incidenti tringëllonte sikur te kishte hyrë një mizë brenda. Dëshmitari i tha vëllait të tij ta godiste. Pas rrahjes ata u dërguan përsëri në dhomën ku u mbajtën. Vëllai i tij u godit nga një oficer tjetër i policisë, i cili ishte më i shkurtër. Të burgosurit tjerë ishin dëshmitarë të kësaj grindjeje dhe dëshmitarët **D. F. dhe S. Rr.**, siç u elaborua më poshtë, dëshmuan në lidhje me këto ngjarje.

182. Ndërsa ishin në kantinë një oficer policie fillonte të numëronte prapa nga 10 në 1, dhe brenda kësaj kohe ata duhej të hanin ushqimin e tyre dhe pastaj të largoheshin, kështu që ata duhej ta kapnin ushqimin dhe ta vendosnin në xhepat e tyre. Të gjithë oficerët e policisë e bënë këtë, përfshirë edhe Z. V.

³² F. P., procesverbali i 9 nëntorit 2017, faqet 29 deri 45

³³ B. M., procesverbali i 13 nëntorit 2017, faqet 22-47

183. **Dëshmitari Shukri Musa** deklaroi se³⁴ burrat u ndanë nga gratë dhe u sollën në burgun e Smrekovnicës më 3 maj 1999. Pas marrjes në pyetje, ai u mbajt në dhomën e televizionit me 300 deri në 400 burra. Për katër ditë nuk mori ushqim, kishte vetëm pak kripë.

184. Pas vizitës në tualet ai u godit nga një person i panjohur me një shkop në shpinë, si rezultat i së cilës ai ra në tokë. Një herë tjetër, një oficer policie i bëri me gisht dhe i tha që të dilte jashtë. Aty dëshmitari dhe vëllai i tij u urdhëruan që të godasin njëri-tjetrin. Ata e goditën njëri-tjetrin lehtë, pas së cilës policët serbë filluan t'i rrahin, sepse nuk po e godisnin njëri-tjetrin aq shumë. Oficeri i policisë i cili iu drejtua dhe e goditi ishte një person i shkurtër. Kishte edhe oficerë të policisë që ishin të gjatë. Grindja zgjati 3 ose 4 minuta. Vëllai i tij B. u godit nga i njëjti polic që e goditi dëshmitarin. Dëshmitari u rrah një herë apo dy herë, B. u rrah më shpesh.

185. Dëshmitari **Sh. B.** arriti në burgun e S. më 23 maj 1999³⁵. Ai u mbajt në një dhomë shumë të ngushtë me 40 njerëz të tjerë për 13 ditë. 72 orët e para nuk mori ushqim apo pije.

186. Z. V. kishte veshur një uniformë policore dhe një kapele ngjyrë blu të errët. Ai kishte një shkop druri dhe gjithashtu kishte armë. Ai i trajtoi njerëzit në mënyrën më çnjerëzore; ai i godiste me çdo gjë që kishte në duart e tij. Kjo ndodhi sa herë që Z. V. ishte në ndërrimin e tij, gjatë ditës ose gjatë natës. Nuk kishte kohë të caktuar, ai i rrihte njerëzit kurdo që i tekej pa një orar të caktuar. Dëshmitari ishte në gjendje ta shihte këtë përmes dritares së dhomës ku ishte mbajtur.

187. Dëshmitari nuk e përjetoi vet rrahjen nga duart e Z. V., por ai dëshmoi për rrahjet e tjera të kryera nga i pandehuri kundër personave të tjerë. Ai gjithashtu shtoi se ishte i tmerruar dhe kishte frikë nga ajo që po ndodhte.

188. Dëshmitari gjithashtu tregoi për masat e kërcënimeve të kryera në kantinë gjatë kohës së ngrënies, megjithëse ai shtoi se nuk e kishte parë Z. V. atje.

189. Dëshmitari **S. H.**³⁶ u dërgua në burgun e S., pasi burrat ishin ndarë nga gratë. Ai u vendos në një sallë të ngjashme me një kinema, sallën e TV-së, ku qëndroi rreth tre javë. Ai u ruajt (ndër të tjerët) nga një person i quajtur Z.. Z. ishte paksa biond dhe mbante një kapelë.

190. Dëshmitari u rrah nga Z. në pëllëmbë dhe në shpinë, sepse nuk i mblodhi siç duhet të gjithë duqet e cigareve të hedhura nga Z. dhe kolegët e tij.

191. Z. e rrihte me shkopin e tij dhe luante muzike duke e rrahur atë. Ai do të fillonte me rrahjen e shuplakave të dorës, ose do të godiste kokën nëse do të largonin duart. Rrahjet më të rënda zakonisht do të ndodhnin menjëherë pasi Z. e pranonte ndërrimin. Dëshmitari tregoi që e kishte dëgjuar të pandehurin duke i thënë një të burgosuri tjetër: “derisa të më tregoni se çfarë ka ndodhur me xhaxhain tim, kjo është ajo që do të merrni”.

³⁴ Sh. M., procesverbali i 13 nëntorit 2017, faqet 3 deri 21

³⁵ Sh. B., procesverbali i 14 nëntorit 2017, faqet 2 deri 24

³⁶ S. H., procesverbali i 14 nëntorit 2017, faqet 24 deri 43.

192. Këdo që i pandehuri do ta rrihte, po të kishin qenë kafshë, do të kishin vdekur. Një i afërm i dëshmitarit ishte rrahur shumë rëndë. Një person tjetër u rrah aq rëndë sa që nuk mund të qëndronte as të shtrihet në dysheme.

193. Dëshmitari ishte rrahur nga i pandehuri në tri raste.

194. Gjithashtu, dëshmitari deklaroi se nuk kishte asnjë mundësi për të përfunduar ushqimin në kantinë, pasi rojet thoshin '3-2-1-0 ngrihuni'. Nëse nuk kishte kohë për të ngrënë bukë, ata do ta merrnin me vete.

195. Dëshmitari **B. F.**³⁷ e hapi kapitullin e viktimave / palëve të dëmtuara nga lagja B.

196. Ai deklaroi se, pas mbërritjes në Burgun e S., u mbajt në sallën e TV-së me 600-700 burra të tjerë. Njerëzit urinonin dhe bënë jashtëqitjet aty sepse nuk mundnin të dilnin jashtë. Katër ditët e para dhe net ai nuk mori ujë apo ushqim.

197. Z. V. u paraqit në burgun e S. në natën e dytë që dëshmitari ishte ndalur atje. Ai e dëgjoi emrin e të pandehurit Z. V. për herë të parë në mëngjesin e 3 majit 1999, kur u largua nga hangari i kooperativës bujqësor ku e kaloi natën. Një grua, e cila dikur punonte në Gjykatë, e njohu Z. V. dhe i tregoi dëshmitarit.

198. Z. V. e rrihte me një shkop druri me ngjyrë të zezë jashtë sallës së TV-së dhe njerëzit e tjerë ishin në gjendje ta shihnin këtë nga dritarja e sallës së TV-së. Dëshmitari e njohu sallën e TV-së në **fotografinë 14 të provës materiale 5**.

199. Si rezultat i rrahjeve, dora e tij u thye. Ai u godit edhe dy herë në kokë, sepse nuk i mbajti duart siç duhej. Ai nuk mori asnjë trajtim mjekësor. Rrahja ndodhi jashtë derës, te shkallët.

200. Dëshmitari shtoi se ai ishte rrahur së bashku me njerëz të tjerë nga fshati B., përkatësisht I. F., S. O., A. O., D. F. dhe J. F.. Z. V. merrej me rajone, jo me emra. Ai thoshte për shembull, 'kush është nga Sh., ju lutem dilni përpara'.

201. I Pandehuri kishte veshur një uniformë, blu disi në gri. Ishte lara-lara dhe shiriti i tij ishte blu. Ishte një uniformë policore.

202. Dëshmitari u rrah nga i pandehuri në 3 ose 4 raste; njëri nga rastet ishte kur dëshmitari u kthye nga dreka, nga kantina. Ai gjithashtu shtoi se të burgosurit, të cilët ishin në pavijone ku rojet 'e rregullta' ishin përgjegjës, nuk pësuan asnjë torturë.

203. Dëshmitari **A. O.**³⁸ u dërgua në kooperativën bujqësore në V. Burrat u ndanë nga gratë dhe u sollën në burgun e S. më 3 maj 1999.

204. Më 5 maj 1999 ai u mor në pyetje. Gjatë marrjes në pyetje ai u rrah me një shkop gome. Pas marrjes në pyetje, ai u soll në sallën e filmit në burg, në sallën e TV-së, ku mbaheshin të paktën 300 burra të tjerë. Nuk kishte asgjë atje fillimisht dhe pak pas aty u soll një fuçi e madhe me ujë. Pas një kohe uji filloi të kontaminohej dhe shumë shpejt njerëzit

³⁷B. F., procesverbali i 16 tetorit 2017, faqet 35-66.

³⁸A. O., procesverbali i 4 dhjetorit 2017, faqet 3 deri 21.

filluan të kishin diarre. Kishte edhe morra dhe pleshta. Dëshmitari mbeti në sallën e TV-së deri më 23 maj 1999.

205. Më famëkeqi nga policët roje ishte Z., sepse kur ai ishte në ndërrim, ai i rrihte njerëzit me një shkop fshese tërë ditën. Ai kishte veshur një uniformë blu.

206. Kushëriri i dëshmitarit, R. O., u thirr jashtë dhe u rrah shumë keq nga Z. Dëshmitari mund ta shihte këtë përmes një dritareje të hapur. Kushëriri i tij mori plagë në duart e tij.

207. Z. tha: Kushdo që është nga B., (13 ose 14 burra) dilni jashtë, ndër të cilët ishin R. O., S. O., Z. F., F. F., D. F., I. F. dhe B. F.

208. Ai i rreshtoi dhe ata duhej të ngrinin mëngët e tyre dhe filloi të rrihte të gjithë shumë rëndë, ai i goditi të gjithë 70 deri në 80 herë me një shkop fshese në duar. Dëshmitari ishte personi i fundit nga B. i cili ishte rrahur, ai u godit 76 herë me një shkop fshese. Sa herë që dëshmitari nuk ishte në gjendje t'i mbante duart, ai u godit në kokë dhe në shpatulla. Kur dëshmitari ofshau "ufff" Z. i tha atij: "Ufff e çka me xhaxhain tim?"

209. Dy herë në ditë ata u lejuan të hanin në kantinë. Kur Z. ishte në ndërrim, ata duhej të vraponin në kantinë dhe rriheshin e shkelmoheshin dhe goditeshin nga një rresht policësh. Për të përfunduar ushqimin, Z. thoshte "i keni 2 minuta për të mbaruar ushqimin". Më shumë se gjysma e njerëzve nuk do të ishin në gjendje të mbaronin ushqimin dhe disa madje u detyruan të ktheheshin pa ngrënë fare.

210. Më 23 maj 1999 të gjithë njerëzit u futën në autobusë dhe u dërguan në kufirin shqiptar, ku u morën të gjitha dokumentet e tyre personale të identifikimit para se të kalonin kufirin.

211. Dëshmitari **I. F.**³⁹ e kaloi natën në kooperativën bujqësore të V. më 2 maj 1999.

212. Të nesërmen burrat u ndanë nga gratë dhe u sollën në burgun e S. Ai qëndroi në sallën e TV-së me 460 burra. Ai nuk mori ushqim për katër ditë. Ishte shumë e pistë dhe njerëzit ishin të mbuluar me morra. Ai qëndroi në burg deri më 25 ose 26 maj 1999 dhe pastaj u soll me autobus në kufirin e Sh.

213. Në një moment të caktuar të gjithë burrat nga fshati B. u urdhëruan të dalin jashtë, ishte një grup prej 13 deri në 14 burra. Dëshmitari ishte i pari që doli. Jashtë ishin të ulur pesë policë në uniformë. Polici i cili e goditi me një shkop fshese, ishte një person shumë i gjatë dhe fizikisht i fortë. Oficeri i policisë i tha dëshmitarit: "Kush i përdhunoi gratë serbe, kush e vrau xhaxhain tim, a ishte UÇK?". Dëshmitari u urdhërua të zgjasë duart dhe u godit me shkop fshese 30-50 herë, dhe kur më nuk ishte në gjendje t'i mbante duart e shtrirë, ai u godit në shpatull.

214. Kur u kthye brenda, burrat tjerë i thanë se oficeri i policisë që e rrahu atë ishte Z., ata e njihnin sepse ishin nga V. dhe Z. punonte në Gjykatën e V.

³⁹ I. F., procesverbali i 4 dhjetorit 2017, faqet 22 deri 36.

215. Të tjerët nga fshati B. u rrahën gjithashtu, u kthyen brenda me duar të ënjtura dhe kishin gjithashtu plagë në shpinë. Dëshmitari kujton se në mesin e tyre ishin D. F., A. O., S. O. dhe B. F.

216. Keqtrajtimi më i ashpër ishte kur ata shkonin për të ngrënë në kantinë, ku kishin vetëm 2 minuta për të përfunduar ushqimet e tyre. Kur fillonin të shërbenin supë në kantinë, të burgosurit nuk ishin në gjendje të hanin supën pasi që duhej më shumë kohë për tu ftohur. Ata vetëm e merrnin bukën dhe iknin.

217. Dëshmitari **D. F.**⁴⁰ mbërriti më 2 maj 1999 në kooperativën bujqësore të V., ku e kaloi natën. Të nesërmen burrat u ndanë nga gratë dhe u sollën në burgun e S. Ai u soll aty në sallën e kinemasë ose në sallën e filmit, në sallën e TV, dhe qëndroi atje 21 ditë. Kishte vetëm një tualet për një numër shumë të madh njerëzish. Pas disa ditësh, u soll një fuçi e madhe me ujë dhe kur ata filluan të pinin këtë ujë të gjithë u sëmurën. Pasi që të gjithë njerëzit nuk ishin në gjendje të përdorin tualetin në të njëjtën kohë, ata e bënë nevojën brenda sallës.

218. Ata nuk ruheshin nga rojet e rregullta të burgut por nga paramilitarët, njëri prej tyre ishte Z. V. Ai e rrahu dhe e keqtrajtoi rëndë kushëririn e dëshmitarit, R. O. dhe kur e lëshoi i tha atij: “Kushdo që është nga B., thuaji të dalin jashtë, mos më detyroni të hyjë brenda dhe t’i nxjerrë të gjithë një nga një sepse do të jetë më keq për ju“. Kështu ata dolën, rreth 20 njerëz, dhe u urdhëruan të zhveshin xhaketat e tyre. Midis tyre ishin B. F., djali i dëshmitarit J. F., kushëri i dëshmitarit I. F. dhe A. O.

219. Z. V. filloi t’i keqtrajtonte ata me një shkop fshese, ata të gjithë morën 60 deri në 70 goditje në duart e tyre. Kjo ndodhi jashtë, përpara ndërtesës, në fund të shkallëve. Një person biond, i cili ishte pak më i shkurtër, e ndihmoi Z. V. në këtë rrahje, kur Z. V. u lodh ai i kërkoi këtij personi tjetër që të vazhdojë. Nuk kishte asnjë trajtim mjekësor në burg.

220. Kur shkonin për të ngrënë, Z. V. hynte dhe e godiste tryezën me shkop dhe numëronte 3, 2, 1, ngrihuni, e keni kryer. Ata vështirë se mund të hanin diçka, kështu që merrnin ca bukë me vete dhe i vendosnin në xhepat e tyre. Kur ktheheshin, policia i formonte dy rreshta, kështu që ata e godisnin dikë me një shkop fshese ose i shkelmonin, varësisht se si goditeshin.

221. Dëshmitari gjithashtu rikujtoi se si i pandehuri sillte pije alkoolike jashtë dhe piqte mish dhe luante këngë nacionaliste.

222. Në fund dëshmitari shtoi se arsyeja për të cilën i pandehuri i urdhëroi burrat nga fshati B. të dilnin jashtë ishte se i pandehuri pretendonte që dikush nga familja e tij u vra në M. ose në rajonin e Sh.

223. Dëshmitari **S. O.**⁴¹ deklaroi se më 2 maj 1999 ai u detyrua të largohej nga fshati ku jetonte dhe u dërgua në burgun e S. Ai u dërgua në një sallë të madhe (ai nuk e dinte nëse kjo ishte një sallë e TV-së), ku qëndronin rreth 200 deri në 300 burra. Nuk kishte vend për të fjetur, vetëm një dysheme nga çimento dhe nuk kishte batanije. Ai u mbajt në burg deri më 23 maj 1999.

⁴⁰ D. F., procesverbali i 29 nëntorit 2017, faqet 2 deri 24

⁴¹ S. O., procesverbali i 7 dhjetorit 2017, faqet 24-41.

224. “Z.” ishte njëri nga oficerët e policisë që i ruanin dhe i rrahu gjatë një nate. Të gjithë burrat nga B. u urdhëruan që të dalin jashtë. Z. ishte i gjatë dhe i trup fortë.

225. Dëshmitari u urdhërua të mbante duart dhe u godit në pëllëmbët e duarve të tij, me diçka nga druri, si dorëz e fshesës, afërsisht një metër e gjatë. Kur ai nuk mundi ti mbante duart e tij siç dëshironte Z., ai u godit në kokë dhe kjo ndodhi dy herë. Dëshmitari nuk e mban në mend sa goditje i ka marr.

226. Shumë njerëz nga B. u rrahën, ndër të cilët ishin I. F., Z. F., A. O., D. F.. Dëshmitari nuk e njihte më parë Z., të burgosurit e tjerë i thanë se emri i tij ishte “Z.”.

227. Një herë tjetër, Z. fshihej prapa një peme dhe e goditi në shpinë derisa dëshmitari po shkonte për darkë. Dëshmitari thekson se ata gjithmonë detyroheshin që të vraponin gjatë rrugës për në kantinë. Shumë herë kur dëgjohej se Z. ishte në ndërrim, dëshmitari nuk shkonte për të ngrënë, sepse nuk mund të vraponte dhe ishte më mirë të mos hante fare se sa të rrihej. Në mbrëmjen kur Z. e goditi, i pandehuri erdhi në kantinë ku dëshmitari ishte duke ngrënë darkë dhe tha “i keni 2 ose 3 minuta për të ngrënë”. Dëshmitari nuk ishte në gjendje të hante asgjë, por mori vetëm pak bukë me vete dhe e la supën.

228. Më 23 maj 1999 ata u futën në autobus dhe u sollën në kufirin e Sh.

229. Dëshmitari **S. Rr.**⁴² gjithashtu rikujton rrahjen që e pësoi nga i pandehuri Z. V.

230. Ai deklaroi se me të hyrë në burgun e S. gjithçka u mor nga ai: 16.500 marka gjermane dhe një sasi e dinarëve serbë me vlerë prej 800 marka gjermane dhe orën e tij të dorës. Për tre ditë nuk mori ushqim apo pije.

231. Në një rën nga ditët e ardhshme, kur të burgosurit u lejuan të hanin në kantinë, Z. V. e nxori dëshmitarin dhe i tha të shtrinte duart. Z. V. e goditi me një shkop në duar, në kokë dhe këmbë. Pas kësaj, dëshmitari u thirr për marrjen në pyetje dhe u godit në pjesën e pasme të kokës.

232. Dëshmitari dëshmoi se si i pandehuri i rrahu disa të burgosur, mes të cilëve edhe fshatarë nga B.

233. Për më tepër, dëshmitari tregoi për ngjarjet e rrahjes së vëllezërve B. dhe Sh. M. Dëshmitari dëshmoi ngjarjen dhe deklaroi se Z. V. mori pjesë në rrahjet e tyre.

234. Z. V. e rrahu edhe S. G. dhe gjithashtu e detyroni një baba dhe djalin e tij të rrihnin njëri-tjetrin, përkatësisht M. M. (babai) dhe F. M. (djali).

235. Dëshmitari më tej shtoi se i pandehuri luante muzikë kombëtare serbe dhe mbante një uniformë blu të policisë, me mbishkrimin “milicija”. Ai ishte aq i gjatë sa që pantallonat e tij dukeshin të shkurtra.

236. Dëshmitari **R. A.**⁴³ dëshmoi se ishte në S. për 29 ditë pas mbërritjes së tij më 2 maj.

⁴² S. Rr., procesverbali i 6 dhjetorit 2017, faqet 5 deri 24.

⁴³ R. A., procesverbali i 6 dhjetorit 2017, faqet 25 deri 45.

237. Z. V. e goditi atë 150 herë me një bisht fshese dhe mori prej tij 2,000 marka gjermane. Dëshmitari gjithashtu pa përmes dritares se si Z. V. i rrahu tre burra të tjerë.

238. Ata kishin dy minuta për të ngrënë në kantinën e burgut. Ai mbante uniformë të zezë policore.

Analiza

• *Njohja e Z. V.*

239. Disa Dëshmitarë kanë dëshmuar para Trupit Gjykses për sa i përket njohurisë së tyre të të pandehurit, duke vërtetuar faktin se ata kanë mundur ta identifikojnë atë një herë në burgun e S.

240. Dy grupe duhet të veçohen. Grupi i dëshmitarëve fillimisht nga V. të cilët kishin njohuri paraprake të Z. V. dhe grupi i dëshmitarëve nga B., të cilët nuk e njihnin të pandehurin, por e kishin mësuar emrin e tij nga dëshmitarët nga V.

Dëshmitarët nga V.

241. Dëshmitarët raportuan se si Z. V. punonte në Gjykatën Komunale në V. dhe gjithashtu e njihnin atë nga raste të tjera.

242. Dëshmitari **S. K.** deklaroi se, në fakt, ai e kishte parë Z. V. për herë të parë gjatë kohës që punonte në gjykatën komunale. Më pas ai tregoi për kohën kur Z. V. e nxori nga një autobus dhe e urdhëroi që të ikte. Përveç kësaj, dëshmitari e shihte Z. V. rreth qytetit të V. dhe në vitin 1999 ai gjithmonë e shihte atë në uniformë.

243. Dëshmitari **S. G.** konfirmoi se Z. V. punonte në Gjykatë, në zyrën me numër 6 dhe shtoi se e ishte takuar shumë herë rreth qytetit të V.

244. Dëshmitari **S. G.** e njihnte Z.. Para se të kalonte në gjykatë, Z. kishte kryer punët ndërtimore në kompaninë "K. V.". Edhe vëllai i dëshmitarit ka punuar atje. Dëshmitari e pa atë në gjykatë.

245. Dëshmitari **M. U.** gjithashtu deklaroi se e dinte se Z. V. punonte në gjykatë, në zyrën numër 6 dhe se e kishte takuar atje tre ose katër herë për vulosjen e dokumenteve.

246. Dëshmitari **B. M.** pohoi gjithashtu se i pandehuri kishte punuar në gjykatë edhe pse ai e njihnte atë vetëm me emrin Z.. Dëshmitari dëshmoi se kur kishte dënime në komunikacion të lëshuara kundër tij, ai shkante në zyrën e Z. në gjykatë, pasi që ai ishte personi që kishte dokumentacionin përkatës.

247. Dëshmitari **F. P.** gjithashtu tregoi se si e njihnte të pandehurin si fytyrë dhe se po punonte në gjykatë, ku e shihte duke hyrë dhe dalë nga gjykata, ndonjëherë duke pirë duhan

para Gjykatës. Dëshmitari shtoi se Z. V. kishte zakon të luante basketboll me të rinjtë pranë shkollës.

248. Dëshmitari **G. H.** i tha trupit gjykues se e njihte të pandehurin vetëm me emrin Z. dhe se vinte disa herë në pompën e benzinës ku dëshmitari punonte dhe se e kishte parë disa herë në V. para luftës. Gjithashtu shtoi se i pandehuri ishte gjithmonë i veshur me rroba civile.

249. Dëshmitari **Sh. B.** deklaroi se e njeh të pandehurin me emrin “Z.” dhe se ka punuar në Gjykatë. Ai e kishte takuar në Gjykatë kur është dashur të merrte dokumente për ndonjë rast në Gjykatë.

250. Dëshmitari **S. Rr.** e njihte Z. V. nga tregu në V., sepse duhej të kishte një leje pune, që duhej të vulosej në Gjykatën e V. në zyrën nr. 6, ku Z. punonte. Dëshmitari e di se Z. V. ka jetuar në rrugën “D. e K.”.

251. Dëshmitari **R. A.** deklaroi se e kishte parë të pandehurin dy herë në gjykatë në V..⁴⁴

252. Për më tepër, fakti që Z. V. ka punuar në gjykatë në V. është një fakt i vërtetuar nga vetë i pandehuri i cili e konfirmoi se ka punuar në Gjykatë.

Dëshmitarët nga fshati B.

253. Dëshmitari **A. O.** deklaroi se të gjithë në sallën e TV-së e njihnin të pandehurin dhe e quanin Z.. Ai kishte veshur një uniformë blu të policisë; ai ishte rreth 180, 185 deri në 2 metra i gjatë, flokë të zeza, dhe më i dobët. Ishte rreth moshës 30, 35 vjeç.

254. Pasi u rrah dhe u kthye brenda ndërtesës së burgut, dëshmitarit **I. F.** mësoi nga burrat tjerë se oficeri i policisë që e rrahu atë quhej Z. dhe se ata e njihnin sepse ishin nga V. dhe Z. punonte në Gjykatën e V.

255. Dëshmitari **B. F.** dëshmoi se e dëgjoi emrin e të pandehurit Z. V. për herë të parë në mëngjesin e 3 majit 1999, kur u largua nga hangari i kooperativës bujqësore ku e kaloi natën. Një grua, e cila dikur punonte në Gjykatë, e njohu Z. V. dhe i tregoi dëshmitarit.

256. Dëshmitari **D. F.** deklaroi se nuk e njihte Z. V. para këtyre ngjarjeve, por e dëgjoi emrin e tij nga të burgosurit e tjerë që e njihnin. Ai e përshkroi atë si një person të gjatë, 1,90 deri në 2 metra, me trup të ndërtuar mirë, flokë të errëta, i moshës 27-29 vjeç.

257. Dëshmitari **S. O.** gjithashtu theksoi se nuk e kishte njohur Z. më parë, por të burgosurit e tjerë i treguan se quhej “Z.”.

258. Dëshmitarët **B. F.** dhe **D. F.** e njohën të pandehurin nga foto-rreshtimi.

Përfundimi

⁴⁴ Shih më lart 25.

259. Njohja e kryerësit e kryer nga dëshmitarët bazohet në themele të forta dhe duke marrë parasysh edhe faktet e padiskutuara të sqaruara më lart, kjo ka qenë arsyeja që trupi gjykues e ka konsideruar si të besueshme dhe bindëse.

• *Rrahjet dhe masat e kërcënimeve të kryera nga i pandehuri kundër viktimave*

260. Bazuar në provat e mësipërme, Trupi Gjykues konstatoi se i pandehuri kreu rrahje të rënda dhe vepra të keqtrajtimit fizik ndaj personave: B. F., S. G., S. G., M. U., F. P., B. M., Sh. M., S. H., A. O., I. F., D. F. dhe S. O., S. Rr. dhe R. A.

261. Për më tepër, i pandehuri shkaktoi vuajtje mendore përmes nxitjes së frikës dhe terrorit kundër të gjitha viktimave të lartpërmendura, si dhe ndaj S. K., G. H. dhe Sh. B..

262. Dëshmitarët i rikujtuan ngjarjet ose si viktima të drejtpërdrejta ose si dëshmitarë okularë. Ata ishin bindës, të saktë dhe e konfirmuan njëri-tjetrin në lidhje me ngjarjet e përgjithshme që kishin të bënin me ndalimin e tyre, rrahjet e kryera nga i pandehuri, si dhe gjendjes së frikësimit dhe terrorit, të cilës iu nënshtruan jo vetëm në kantinë, por në përgjithësi gjatë gjithë kohës së burgosjes së tyre.

263. Dëshmitarët madje e konfirmuan njëri-tjetrin në lidhje me mënyrat e përdorura nga i pandehuri në kryerjen e rrahjeve (nëse duart tërhiqeshin atëherë ai i godiste në kokë ose në supe) dhe gjithashtu në lidhje me hollësitë karakteristike që i rrethonin rrahjet, përkatësisht fakti që i pandehuri luante këngë nacionaliste gjatë kryerjes së veprimeve dhe së bashku me rojet e tjera pinte alkool dhe piqte mish. Të gjitha këto detaje u raportuan vazhdimisht nga shumica e dëshmitarëve.

264. Përshkrimi i vendit ku ndodhën ngjarjet gjithashtu vërteton deri në nivel të konkludimit. Të gjithë dëshmitarët kanë folur për qëndrimin e tyre në sallën e TV-së dhe salla e tillë e TV-së është përmendur qartë dhe është shënuar nga disa dëshmitarë në **provat 5 dhe 6**.

265. Të gjithë dëshmitarët, pastaj, dëshmuan sa i takon asaj se si ndodhën rrahjet jashtë kësaj sale të TV-së, afër shkallëve të hyrjes të sallës, dhe ata kanë mund të shihnin ato rrahje nëpër dritaret e sallës së TV-së.

266. Trupi Gjykues gjithashtu i konsiderojë deklaratat e Dëshmitarëve si objektive në rrëfimet e tyre dhe pa ndonjë qëllim ose motiv për të fajësuar rrejtshëm. Në të vërtetë, disa dëshmitarë kanë deklaruar se janë rrahur vetëm një herë nga i Pandehuri.

267. Natyrisht se Trupi Gjykues ka vërejtur disa mospërputhje dhe disa zmadhime në disa nga dëshmitë, përkatësisht mospërputhje në deklaratat e vëllezërve M. lidhur me rrahjen e tyre dhe mbivlerësimin e dhënë nga Dëshmitari R. A. në kujtimin e tij të rrahjeve të marra.

268. Mirëpo, Trupi Gjykues, së pari, i konsideroi këto mospërputhje jo aq thelbësore sa të dyshoj për fajësinë e të Pandehurit. Në të vërtetë, Sh. M. dëshmoi për praninë e një oficeri me të gjate policor në grupin e oficerëve që e detyruan atë të rrihej me vëllain e tij. Për më tepër, deklarata e B. M. u vërtetua nga dëshmitarët tjerë okular, si D. F. dhe S. Rr..
269. Prandaj, Trupi Gjykues, përveçse nuk i konsideroj këto mospërputhje se e prishin inkriminimin e të Pandehurit në këtë pikë, i futi ato në pjesën e mospërputhjeve të pashmangshme që rrodhen nga kalimi i kohës.
270. Lidhur me zmadhimin e mundshëm të ngjarjeve në deklaratën e dëshmitarit R. A., gjithashtu edhe në këtë rast Trupi Gjykues konsideroj se elementet e mbivlerësimit të përshkruara në deklaratën e dëshmitarit nuk e diskreditojnë inkriminimin e të Pandehurit në ndonjë mënyrë dhe ato mund të lidhen me një gjendje të dukshme emocionale që ende mbart dëshmitari. Në të vërtetë, përveç këtyre ekzagjerimeve nga sa thuhet, deklarata e dëshmitarit vërteton dhe vërtetohet nga deklaratat e dëshmitarëve të tjerë.

- ***Përfundimi për Akuzën III***

271. Trupi Gjykues, prandaj, konsideroi si të provuar se i pandehuri Z. V. rrahu në mënyrë të strukturuar B. F., S. G., S. G., M. U., F. P., B. M., Sh. M., S. H., A. O., I. F., D. F. dhe S. O., S. Rr. dhe R. A., dhe i nënshtroj që të gjithë, si dhe S. K., Sh. B. dhe G. H. deri në masat e frikësimit, kërcënimit dhe terrorit.
272. Në të njëjtën kohë, gjatë kohës se Gjykimit nuk dolën elemente që tregonin nivelin e përfshirjes, nëse ka pasur, të të Pandehurit në operimet që çuan në burgosjen e viktimave në burgun e S..
273. Kështu, Trupi Gjykues nuk mundi të konsideroj si të provuar se i Pandehuri Z. V. mori pjesë në burgimin e paligjshëm të një numri të madh të popullatës civile Shqiptare, në burgun e S.

F. KUALIFIKIMI LIGJOR

274. Trupi Gjykues është dashur të vlerësojë nëse faktet e konsideruara si të provuara është baras me “Krimeve të luftës kundër popullatës civile” të kryer në bashkëkryerje, të parapara dhe të dënueshme me Nenin 142 lidhur me Nenin 22 të KPRSFJ-së dhe aktualisht të kriminalizuara sipas Nenit 152, 153 dhe 31 të KPK-së.

- **Elementet e Krimeve të Luftës**

275. Se është kryer një krim lufte, duhet të provohen elementet e mëposhtme:

- (a) **ekzistenca e konfliktit të armatosur**
- (b) **e ashtuquajtura lidhja**

- (c) **statusi i viktimave, ndryshe personat e mbrojtur**
- (d) **dispozitat ekzistuese të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe pesha ose serioziteti i shkeljes**
- (e) **përgjegjësia penale individuale**

- ***Ekzistenca e konfliktit të armatosur jo ndërkombëtar***

276. Në lidhje me ekzistencën e konfliktit të armatosur në periudhën e lartpërmendur, Gjykata i merr si të vërteta faktet e pranuar përgjithësisht pa pasur nevojë të vërtetohen konstatimet e Dhomave të Gjykatës të Tribunalit të Hagës, si jurisprudencë të pranuar dhe të njohur, si dhe jurisprudencën e Gjykatave vendore.
277. Kriteri për përcaktimin e ekzistencës së konfliktit të armatosur është vendosur nga Dhoma e Apelit në Juridiksioni e Vendimit të T.:

“Konflikti i armatosur ekziston kur ekziston qasja në force të armatosur në mes Shteteve ose dhune afatgjate e armatosur në mes të autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara ose midis grupeve të tilla brenda një Shteti. Ligji ndërkombëtar humanitar zbatohet nga fillimi i konflikteve të tilla të armatosura dhe shtrihet përtej ndërprerjes së armiqësive derisa të arrihet përfundim i përgjithshëm i paqes; ose, në rastin e konflikteve të brendshme, kur arrihet zgjidhja paqësore. Deri në atë moment, ligji ndërkombëtar humanitar vazhdon të zbatohet në gjithë territorin e Shteteve ndërluftuese ose, në rastin e konflikteve të brendshme, në gjithë territorin nën kontrollin e një pale, pavarësisht nëse aktualisht aty ndodh ose jo luftimi”⁴⁵.

278. Prandaj, duhet të përcaktohet (i) a është dhune e armatosur afatgjate, (ii) intensiteti i saj dhe (iii) a kanë qene palët në konflikt të organizuara.

279. Në rastin L.⁴⁶, Dhoma e Gjykatës se Hagës fillimisht vlerësoi se:

“Forcat serbe të përfshira në Kosovë në vitin 1998 përbenin forca të konsiderueshme të Ushtrisë së Jugosllavisë (“UJ”) dhe të Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme (“MPB”), 321 domethënë policinë, dhe prandaj, përbënte “autoritetet qeveritare” brenda kuptimit të kriterit T.”

280. Duke kaluar pastaj tek analizua e strukturës organizative e UÇK-së dhe duke detajuar zhvillimin e UÇK-së dhe formimit e njësisive të UÇK-së, Dhoma vlerësoi se ka ekzistuar Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së i cili caktonte dhe emëronte zonat e ndryshme operative dhe se:

“..nga fundi i majit deri në fund të gushtit 1998, territori i Kosovës ishte i ndare nga [Ushtria Çlirimtare e Kosovës] UÇK në shtatë zona: D., D., P., Sh., Ll., N. dhe K.. Secila zonë kishte komandant dhe mbulonte territorin e disa komunave. Niveli i organizimit dhe zhvillimit në secilën zonë ishte fluid dhe në zhvillim dhe të gjitha

⁴⁵ Prokurori kundër D. T. i njohur si “D.”, Vendim për Propozimin e Mbrojtjes për Ankesën e përkohshme mbi Kompetencat, 2 tetor 1995, paragrafi 70.

⁴⁶ Prokurori kundër F. L. dhe të tjerëve, Nr. i lëndës IT-03-66-T, 30 nëntor 2005, para. 93.

zonat nuk kishin nivel të njëjte të organizimit dhe zhvillimit, pasi kjo në mase të madhe ndikohej nga ekzistenca dhe shtrirja e pranisë së UÇK-së në secilën zonë para prillit të vitit 1998”⁴⁷.

281. Dhoma pastaj konstatoje një formalitet dhe efektivitet të rritur të strukturës organizative të UÇK-së deri në mesin e muajit maj 1998 dhe progres të Shtabit të Përgjithshëm në drejtim të sigurimit se UÇK-ja funksiononte si forcë ushtarake e disiplinuar dhe e koordinuar⁴⁸.

282. Për më tepër, Dhoma gjithashtu vlerësoje se si në korrik të vitit 1998 UÇK-ja u pranua nga përfaqësuesit ndërkombëtarë, dhe brenda në Kosovë, si palë kryesore e përfshirë në negociata politike për të zgjidhur krizën e Kosovës:

“Kjo zbulon dhe konfirmon se deri në atë kohë UÇK-ja kishte arritur një nivel stabiliteti dhe efektiviteti organizativ⁴⁹”.

283. Duke u kthyer pastaj tek intensiteti i konfliktit, Dhoma ishte e kënaqur se, për shkak të intensitetit të përleshjeve dhe aftësisë së UÇK-së për të hyr në konflikte të tilla:

“para fundit të majit të vitit 1998 ekzistonte një konflikt i armatosur në Kosovë në mes të forcave Serbe dhe UÇK-së”⁵⁰.

284. Dhoma e Gjykatës në rastin H.⁵¹ me tutje e argumentoj dhe konstatoj se ka ekzistuar konflikti i armatosur në Kosovë **nga 22 prilli 1998 e tutje**.

285. Konflikti i armatosur përfundoj më **20 qershor 1999**⁵², kur Sekretari i Përgjithshëm i NATO -s zyrtarisht e përfundoj fushatën e sulmeve ajrore.

286. Vendimi i Gjykatës Supreme i datës 21 korrik 2005 në rastin *L. G. dhe të tjerë* gjithashtu konstatoj se në mes të gushtit 1998 dhe mesit të qershorit të vitit 1999 struktura organizative e UÇK-së i plotësonte kërkesat sipas Nenit të Përbashkët 3 të Konventave të Gjenevës dhe Protokollit Shtesë II.⁵³

287. Trupi Gjykues e konstatoj si të vërtetuar se afati kohor gjatë të cilit civilët i ishin nënshtruar trajtimit çnjerëzor nga i akuzuari Z. V. ka rrjedhur nga 03 maji i vitit 1999 deri në fillim të qershorit të vitit 1999. Prandaj, ngjarjet ndodhën gjatë ekzistencës së konfliktit të armatosur të brendshëm në Kosovë.

- Lidhja

288. Trupi Gjykues e ndoqi konceptin e zbatuar nga Tribunali i Hagës lidhur me domosdoshmërinë e lidhjeje në mes të veprimit të të akzuarit dhe konfliktit të

⁴⁷ *Ibid*, para 95.

⁴⁸ *Ibid*, para 117.

⁴⁹ *Ibid*, para 129.

⁵⁰ *Ibid*, para 171.

⁵¹ *Prokurori kundër R. H. dhe të tjerët*, lënda Nr IT-04-84-T, 03 prill 2008, para 100.

⁵² Shihni Aktgjykimin e Gjykatës Supreme në rastin *L.*, si dhe Rregulloren e UNMIK- ut 2006/50.

⁵³ Vendimi i Gjykatës Supreme në *L. G. dhe të tjerët*, 21 korrik 2005, faqe 10, versioni Anglisht.

armatosur, për të klasifikuar veprën penale të kryer gjatë konfliktit i armatosur si krim të luftës.

289. Në rastin T., Dhoma e Apelit e Tribunalit të Hagës shprehu mendimin se:

“Duhet të ekzistoj lidhja e qartë midis aktit kriminal dhe konfliktit të armatosur ... Mjafton që krimet e pretenduara të jenë të lidhura ngushtë me armiqësitë që ndodhin në pjesë të tjera të territoreve të kontrolluara nga palët në konflikt”⁵⁴.

290. Një shpjegim më i hollësishëm mbi këtë çështje është paraqitur nga Dhoma e Apelit e Tribunalit të Hagës në rastin K.:

*“Ajo që në fund të fundit e dallon krimin e luftës nga vepra e pastër vendore është se krimi i luftës formohet ose varet **nga mjedisi** - konflikti i armatosur - në të cilin është kryer. Nuk është e nevojshme të jetë planifikuar apo mbështetur nga ndonjë formë e planit ose e politikave. Konflikti i armatosur nuk është e nevojshme të ketë qenë shkak për kryerjen e krimin, **por ekzistenca e konfliktit të armatosur duhet, të paktën, të ketë luajtur në pjesën me të madhe në aftësinë e kryerësit për të kryer atë, vendimin e tij për ta kryer atë, mënyrën në të cilën është kryer ose qëllimi për të cilin është kryer. Prandaj, nëse mund të konstatohet, si në rastin në fjalë, se kryerësi ka vepruar në mbështetje ose nën maskën e konfliktit të armatosur, do të mjaftonte të konkludohej se veprat e tij ishin të lidhura ngushtë me konfliktin e armatosur [. . .]”⁵⁵;***

291. Trupi Gjykes ka vlerësuar se veprimet që janë kryer nga i Akuzuari në burgun e S. kundër viktimave civile Shqiptare ishin të lidhura qartë me situatën e krijuar nga konflikti i armatosur që ishte duke u zhvilluar.

292. Ndarja e qindra burrave të moshës ushtarake nga gratë, fëmijët dhe pleqtë që ndodhi në kooperativën bujqësore më 03 maj dhe më vonë transferimi i burrave të zgjedhur në S. ishte qartazi pjesë e një aksioni ushtarak të kryer nga forcat Serbe kundër popullatës civile Shqiptare.

293. I pandehuri, i cili zakonisht ka punuar si nëpunës i gjykatës në Gjykatë në V., ishte regjistruar si rezervist i policisë S. gjatë periudhës së konfliktit të armatosur, dhe pastaj ishte punësuar si roje burgu në burgun e S. gjate kohës kritike.

294. Konflikti që po zhvillohej e pamundësoj çfarëdo aktiviteti të mbrojtjes dhe garancive nga qeveria duke përfshirë ato që është dashur të ofroheshin nga institucionet shtetërore të zbatimit të ligjit, të cilat në vend të kësaj morën pozitën e armikut dhe persekutuesit të popullatës civile Shqiptare. Civilët ishin privuan nga çdo formë e mbrojtjes ligjore kundër akteve arbitrare dhe sulmuese.

295. I Akuzuari ka vepruar brenda këtij ambienti, derisa ka gëzuar mosndëshkim të përkohshëm.

⁵⁴ Shih S. numër 45, para 70.

⁵⁵ Prokurori kundër K., R. K. dhe Z. V., Dhoma e Apelit, Aktgjykimi i 12 qershorit 2002, par a 58 dhe 59.

296. Trupi Gjykses, prandaj, e konstatoi lidhjen e dukshme midis veprimeve të kryera nga i Pandehuri dhe të konfliktit të armatosur.

- *Statusi i viktimave – i personave të mbrojtur*

297. Për të gene të mbrojtur me Ligjin Ndërkombëtar Humanitar, viktimat duhet të konsiderohen si persona të mbrojtur. Neni 3 i Përbashkët i Konventave të Gjenevës i përkufizon personat e mbrojtur, si ata që nuk marrin pjesë aktive në luftime, duke përfshirë edhe pjesëtarët e forcave të armatosura që kanë hedhur armët dhe ata të vendosur si ' hors de combat ' nga sëmundja, plagët, burgimi ose ndonjë shkak tjetër.

298. Neni 4 i Protokollit Shtesë II të Konventave të Gjenevës gjithashtu shtrin mbrojtjen nga LNH për të gjithë personat që nuk marrin pjesë drejtpërdrejtë ose që kanë pushuar së marri pjesë në luftime.

299. Dhoma e Gjykatës se Hagës në rastin *H.* konstatoi se: |

“është situata konkrete e viktimës në momentin kur është kryer krimi që duhet të merret parasysh në përcaktimin e mbrojtjes se tij ose saj sipas Nenit të Përbashkët”⁵⁶

300. Kryerësi duhet të dijë ose është dashur të dije statusin e viktimave si persona që nuk marrin pjesë aktivisht në luftime.

301. Dhe përsëri, në rastin *G.*, Dhoma e Gjykatës se Tribunalit të Hagës ka vërtetuar si:

“ qe të provohet mens rea e njohur nga Protokollit Shtesë I, Prokuroria duhet të tregojë se kryerësi ishte në dijeni ose është dashur të jetë në dijeni për statusin civil të personave të sulmuar. Në rast të dyshimit për statusin e një personi, ai person konsiderohet civil. Megjithatë, në raste të tilla, Prokuroria duhet të tregojë se në rrethana të caktuara një person i arsyeshëm nuk ka mund të besoj se personi ai apo ajo i sulmuar ishte luftëtar”⁵⁷.

302. Në rastin në fjalë, të gjitha viktimat ishin civilë dhe nuk ka indikacion që ndonjëri nga dëshmitarët ose palët e dëmtuara ka marrë pjesë drejtpërdrejtë (AP2 Neni 4) ose aktivisht (Neni 3 i Përbashkët) në luftime.

303. Dhomat Gjykatës në rastin *T.* deklaroi si:

⁵⁶ Prokurori kundër *S. H.*, Aktgjykimi i 16 nëntorit 2005, III.A.2.

⁵⁷ Prokurori kundër *S. G.*, Aktgjykimi i 05 dhjetorit 2003, para 55.

“... pjesëmarrja aktive në luftime është përkufizuar nga delegatët si “akte luftime të cilat për nga natyra ose qëllimi i tyre mund t’u shkaktojnë dëme reale personelit dhe pajisjeve të forcave të armatosura të armikut”⁵⁸.

304. Dhoma e Gjykatës më tej mori parasysh Komentarët e KNKK-së, ku thuhet se:

“për të kufizuar [konceptin e pjesëmarrjes direkt në luftime] për të luftuar dhe për operime aktive ushtarake do të ishte shumë e ngushtë, ndërsa duke e shtrire atë deri në gjithë përpjekjen e luftës do të ishte shumë e gjerë ... [dhe se] ... në luftën moderne gjithë popullata merr pjesë në përpjekjen e luftës deri në një mase, megjithëse indirekt .. [por] **pjesëmarrja aktive në luftime nënkupton një marrëdhënie të drejtpërdrejtë shkakore në mes të aktivitetit të angazhuar dhe dëmit që i bëhet armikut në atë kohë dhe vend ku zhvillohet aktiviteti.**⁵⁹”

305. Dëshmitarët kanë dëshmuar për sa i përket asaj se ata nuk ishin anëtarë të UÇK-së. Dëshmitari Sh. G. deklaroi se ai u ofroi ndihmë mjekësore dy civilëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe se, si i tillë, ai duhej të ishte formalisht anëtar i UÇK-së. Megjithatë, ai veprroi vetëm në cilësinë e mjekut të përgjithshëm. Kur ofronte ndihmën mjekësore ai e vishte mantelin e bardhë.

306. Dëshmitarët B. M., D. F., S. Rr., S. O., S. G. dhe B. F. të gjithë e mbajnë në mend se si, pas arritjes në burgun e S., u morën në pyetje dhe u akuzuan se janë anëtarë të UÇK-së, të cilën gjë e mohuan vendosmërisht të gjithë. Ata pastaj u detyruan të nënshkruajnë kundër vullnetit të tyre një deklaratë që pretendonte se ata ishin terroristë. Prandaj, mund të përfundohej objektivisht nga modaliteti i burgimit se ishte fakt i njohur brenda burgut se të burgosurit ishin civilë dhe jo anëtar të UÇK-së dhe se ata nuk ishin përfshirë aktivisht në luftime në kohën përkatëse.

307. Dëshmitarët konfirmuan se si ata gjithmonë kanë pasur të veshura rroba civile dhe kurrë nuk kanë mbajtur armë, dhe kjo u deklarua edhe nga viktimat gjatë marrjes në pyetje pas arritjes në burgun e S.

308. S. G. më tej dëshmoi për atë se si i Pandehuri i tha dëshmitarit se e dinte se dëshmitari nuk ishte anëtar i UÇK-së, por që ai i kishte dhënë ‘njëfarë ndihme’ UÇK-së.

309. Trupi Gjykues pastaj nga provat e paraqitura ka mund të nxjerrë përfundimin se i Pandehuri ishte i vetëdijshëm se viktimat ishin civilë.

- ***Në kundërshtim me rregullat e së drejtës ndërkombëtare në fuqi në kohën e luftës, konflikti i armatosur apo pushtimi - përkufizimi i akteve të ndaluara- dhe pesha/serioziteti i shkeljes të së drejtës ndërkombëtare humanitare***

310. Që një sjellje të barazohet me krim të luftës, duhet të provohet se shkelja përbën shkelje të rregullës të së drejtës ndërkombëtare humanitare, qoftë e natyrës zakonore ose e rregulluar sipas dispozitave dhe kërkesave të traktatit.

⁵⁸ Shih S. numër 45, para. 616.

⁵⁹ Komentari i KNKK-së për Protokollin Shtesë I, par. 1679.

311. Rregulla e pare e së drejtës ndërkombëtare humanitare që është marr konkretisht me mbrojtjen humanitare në situata të konfliktit të armatosur jo ndërkombëtare ishte Neni 3 i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës e miratuar më 12 gusht 1949:

Në rast të konfliktit të armatosur të karakterit jo ndërkombëtar që ndodh në territorin e njëjës prej Palëve të Larta Kontraktuese, secila Palë në konflikt është e detyruar të zbatojë, si minimum, dispozitat e mëposhtme:

"....., veprimet në vijim janë dhe do të mbeten të ndaluara në çdo kohë dhe në çdo vend sa i përket personave të lartpërmendur:

(a) Dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasja e të gjitha llojeve, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura;

(b) Marrja e pengjeve;

(c) Shkelja e dinjitetit personal, në veçanti trajtimi poshtërues dhe degradues;

(d) Miratimi i dënimeve dhe kryerja e ekzekutimeve pa shpallur paraprakisht ndonjë aktgjykim nga një Gjykatë e themeluar sipas rregullave, sigurimi i të gjitha garancive gjyqësore që njihen si të domosdoshme nga popujt e civilizuar."

312. Për më tepër, për tu konstatuar shkelja e Nenit 3 të Përbashkët, shkelja duhet të jetë "serioze", domethënë, ajo duhet të përbëjë shkelje të një rregulle që mbron vlera të rëndësishme dhe shkelja duhet të përfshijë pasoja të rënda për viktimën.

313. Dhoma e Gjykatës e Tribunalit të Hagës në rastin *K.* gjithashtu përmendi faktin se:

"Është vendosur mirë në jurisprudencën e Tribunalit se Neni 3 i përbashkët i përcaktuar në Konventat e Gjenevës ka fituar statusin e së drejtës zakonore ndërkombëtare, ... dhe në veçanti, dispozita e shkeljeve të rënda natyrisht që konsiderohet si pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare dhe shkeljet e rënda të saj menjëherë do t'i plotësojnë katër kërkesat e përmendura më lart"⁶⁰.

314. Katalogu i akteve që duhet të ndalohen është plotësuar me Nenin 4 Paragrafin 2 të Protokollit Shtesë II i cili pjesërisht përsëriti formulimin e Nenit të përbashkët 3. Ai rekomandoj penalizimin e akteve të mëposhtme:

"(a) dhuna ndaj jetës, shëndetit dhe mirëqenies fizike ose mendore të personave, veçanërisht vrasja, si dhe trajtimi mizor si tortura, gjymtimi ose ndonjë formë e ndëshkimit fizik;

(b) dënimet kolektive;

(c) marrjen e pengjeve;

⁶⁰ Shih s. numër 55, para 68.

(d) aktet e terrorizmit;

(e) shkelja e dinjitetit personal, në veçanti trajtimi poshtërues dhe degradues, dhunimi, prostitucioni i detyruar dhe çdo formë e sulmit të pahijshëm;

(f) skllavëria dhe tregtia e skllevërve në të gjitha format e tyre;

(g) plaçkitja;

(h) kërcënime për të kryer ndonjë nga aktet e mësipërme.”

315. Konventat e Gjenevës e muajit gusht e vitit 1949, me Nenin e tyre të përbashkët 3, u ratifikuan nga Republika Popullore Federative e Jugosllavisë më 15 shtator 1950. Më 26 dhjetor 1978 Protokolli Shtesë II i katër konventave të Gjenevës u ratifikua nga Republika me emrin e saj të ri, domethënë si Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë.⁶¹

316. Dispozitat e traktatit u transkriptuan brenda vendit në trupin e KPRSFJ-se.

317. Neni 142 i KPRSFJ-së thotë:

“Kushdo që në kundërshtim me rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e luftës, konfliktit të armatosur apo pushtimit, urdhëron që popullata civile t'i nënshtrohet vrasjeve, torturave, trajtimit çnjerëzor, eksperimenteve biologjike, vuajtjeve të mëdha apo dhunimit të integritetit trupor apo shëndetit; zhvendosjes apo shpërngulja apo shndërrimi i dhunshëm në një shtetësi apo besim tjetër; prostitucion apo përdhunim të detyruar; aplikimin e masave të shkaktimit të frikës dhe terrorit; marrja e pengjeve, vënia e ndëshkimit kolektiv, sjellje e kundërligjshme në kampe përqendrimi dhe arrestime të tjera të kundërligjshme e paraburgosje, privim nga e drejta e gjykimit të drejte dhe të paanshëm; shërbimi me dhunë në forcat ushtarake të ushtrisë armike apo në shërbimin e saj të inteligjencës apo administratës; pune të dhunshme, zija e bukës për popullatën, konfiskimin e pronës, plaçkitjen, shkatërrimin e paligjshëm dhe me qëllim si dhe vjedhjen në shkallë të madhe të pronës që nuk justifikohet për nevojat ushtarake, marrjen e paligjshme të kontributit jo-proporcional apo rekuizimin, zhvlerësimi i valutës së brendshme apo hedhja në treg në mënyrë të kundërligjshme e valutës së re, apo kushdo që kryen njërin nga aktet paraprijëse, do të dënohet me jo më pak se pesë vite apo me dënim me vdekje”.

318. Ndryshimi i Nenet 142 të KPRSFJ që ka hyrë në fuqi më 30 gusht 1990 e zgjeroi fushëveprimin e kriminalizimit të akteve kundër civilëve. Përveç krimeve të shumta kundër popullatës civile, ai gjithashtu kriminalizoi si krim lufte sulmin kundër civilëve ose personave të caktuar të paafte për të luftuar, që rezultuan me vdekje, lëndime të rënda trupore apo dëmtime serioze të shëndetit të njerëzve.⁶²

⁶¹ Međunarodni ugovori në 1083 (kontratat ndërkombëtare në 1083).

⁶² Službeni List RSFJ 38/90 (Gazeta zyrtare e RSFJ 38/90).

319. Në këtë mënyrë, përveç natyrës zakonore të dispozitave sipas Nenit të Përbashkët 3, dispozitat përkatëse të traktatit ishin ratifikuar në kohën e kryerjes së veprave penale.

320. Jurisprudenca e Tribunalit të Hagës konstatoi se shkelja e së drejtës ndërkombëtare humanitare është serioze nëse përbën:

“shkelje të rregullës që mbron vlera të rëndësishme dhe shkelja duhet të ketë pasojë të rënda për viktimën”.⁶³

321. Edhe pse specifik për elementet e akteve të torturës, Dhoma e Gjykatës e Tribunalit të Hagës në rastin *K. dhe tjerë*⁶⁴ deklaroi se:

*“Dëmtimi i shëndetit fizik ose mendor do të merret parasysh gjatë vlerësimit të peshës së dëmit të shkaktuar. Keqpërdorimi i barabarte me torturën **nuk duhet domosdoshmërisht të përfshijë lëndimin fizik**, sepse dëmi mendor është formë e përhapur e shkaktimit të torturës. Për shembull, **vuajtja mendore** e shkaktuar ndaj një individi, i cili është i detyruar të shikojë keqtrajtim të rëndë që i shkaktohet një të afërmi, do të ngritët deri në nivelin e peshës së kërkuar nga krimi i torturës”*.

322. Dhoma e Gjykatës në rastin *D., M. dhe të tjerë* (rasti i kampit “Ç.”), ka elaboruar hollësisht për atë që përbën ‘*atmosferë terrori*’. Ai ka deklaruar se:

*“të burgosurit në burgun-kampin C. vazhdimisht ishin dëshmitarë të abuzimit më të rënd fizik që u shkaktohej viktimave të pambrojtura. Kjo prove tregon më tutje se si të burgosurit në kushte të burgimit të një numri të madh njerëzish ishin detyruar të shikonin pa dëshirë dëmtimet dhe vuajtjet e tmerrshme të shkaktuara nga ky keqtrajtim.”*⁶⁵

323. Dhe përsëri:

*“... të burgosurit në kampin-burgun Ç. iu ekspozuan kushteve në të cilat jetuan në ankth dhe frikë të vazhdueshme se do t’i nënshtrohen keqtrajtimit fizik. Përmes veprave të shpeshta të egra dhe të dhunshme të kryera në kamp-burg, të rënduar nga natyra e rastësishme e këtyre veprimeve dhe kërcënimeve të bëra nga rojet, të burgosurit i nënshtroheshin një presioni të madh psikologjik i cili mund të karakterizohej me saktësi si ‘atmosferë terrori’.”*⁶⁶

324. Dhoma e Gjykatës së Tribunalit të Hagës në rastin *V.*, pohoi se:

“.. për të vlerësuar seriozitetin e një akti, duhet t’i kushtohet vëmendje të gjitha rrethanave faktike. Këto rrethana mund të përfshijnë natyrën e veprimit ose mosveprimit, kontekstin në të cilin ndodhi, rrethanat personale të viktimës duke përfshirë moshën, gjininë dhe shëndetin, si dhe efektet fizike, mendore dhe morale të veprimit mbi viktimën Ndonëse nuk ka kërkesë që vuajtjet e shkaktuara nga

⁶³ Rasti K., s. numër 55, para. 66.

⁶⁴ Prokurori kundër K. dhe të tjerët, Aktgjykimi i 2 nëntorit 2001, para 149.

⁶⁵ Prokurori kundër D., M. dhe të tjerëve, Aktgjykimi i 16 nëntorit 1998, para. 1086.

⁶⁶ *Ibid*, para. 1091.

*veprimi kanë efekte afatgjata në viktimën, fakti që një veprim ka pasur efekte afatgjata mund të jetë i rëndësishëm për përcaktimin e seriozitetit të aktit.*⁶⁷

325. Saktësisht për elementet konstitutive të dhunës mbi dinjitetin personal, Dhoma e Gjykatës së Tribunalit të Hagës në rastin *K.*, duke iu referuar asaj që është deklaruar nga Dhoma e Gjykatës së Tribunalit të Hagës në rastin *A.*, përkatësisht se:

*“Dhuna kundër dinjitetit personal është akt që është nxitur nga përbuzja për dinjitetin njerëzor të një personi tjetër. Konkluzioni është që akti duhet të shkaktojë poshtërim apo degradim serioz për viktimën. Nuk është e nevojshme që akti të dëmtojë drejtpërdrejt mirëqenien fizike ose mendore të viktimës. Mjafton që akti t'i shkaktojë vuajtje të vërtetë dhe të qëndrueshme individit që vjen nga poshtërimi apo tallja”*⁶⁸,

326. megjithatë, Gjykata pohoi se:

*“Përderisa poshtërimi apo degradimi është i vërtetë dhe serioz, Dhoma e Gjykatës nuk mund të shohë asnjë arsye pse kjo do të duhej gjithashtu të jetë “e qëndrueshme”. Sipas pikëpamjes së Dhomës së Gjykatës, nuk është e hapur për të konsideruar faktin se viktima është shëruar ose është duke i tejkaluar efektet e një vepre të tillë, siç tregohet vetvetiu se aktet përkatëse nuk përbënin dhune mbi dinjitetin personal. Natyrisht, nëse poshtërimi dhe vuajtja e shkaktuar është vetëm e shkurtër nga natyra, mund të jetë e vështirë të pranohet se është e vërtetë dhe serioze. Megjithatë kjo nuk sugjeron që çdo lloj kërkesë minimale kohore e efekteve të një dhune mbi dinjitetin personal është element i veprës”*⁶⁹.

327. *Mens rea* e akteve çnjerëzore plotësohet kur shkelësi, në kohën e veprimit ose mosveprimit, kishte për qëllim të shkaktojë vuajtje të rënd fizike ose mendore, ose për të kryer sulm të rëndë mbi dinjitetin njerëzor të viktimës, ose ku e dinte se veprimi ose mosveprimi i tij ka mundur të shkaktojë vuajtje serioze fizike ose mendore ose sulm serioz ndaj dinjitetit njerëzor dhe ishte i pamatur⁷⁰.

328. Siç u tha më lart, Trupi Gjykses ka konstatuar si të provuar se i Pandehuri Z. V. rrahu në mënyrë të strukturuar disa të burgosur shumë të ashpër gjatë një periudhe të gjatë kohore. Dëshmitarët treguan ashpërsinë e rrahjeve, mënyrën mizore në të cilën janë kryer rrahjet (nëse viktimat do të ulnin dorën, atëherë ata do të rriheshin në kokat dhe/ose shpatullat e tyre), vetë numri i rrahjeve të pranuar.

329. Viktimat treguan se si pas rrahjeve duart e tyre ishin të fryra dhe duhej t'i mbështillnin duart me çorapë të lagur në ujë. Dy dëshmitarë gjithashtu kujtuan se si duart dhe kyçet e tyre u thyen dhe shumë viktima treguan se ata tash ende vuajnë nga pasojat e këtyre rrahjeve, megjithëse, siç theksohet në jurisprudencën e mësipërme të Gjykatës së Hagës, ky element nuk do të ishte thelbësor për elementin e seriozitetit/peshës, por kjo vetëm vërteton me shumë rrethanat e veprimeve.

330. Përveç aspektit fizik të rrahjeve, Trupi Gjykses mori parasysh edhe vuajtjen e madhe mendore të cilës iu nënshtruan viktimat dhe mënyrën se si ata u tmerruan dhe

⁶⁷ Prokurori kundër *M. V.*, Aktgjykimi i 29 nëntorit 2002, para 235.

⁶⁸ Prokurori kundër *A.*, Rasti Nr. IT-95-14 / 1-T, Aktgjykimi i 25 qershorit 1999, par. a. 49.

⁶⁹ Shih s. 55, para 501.

⁷⁰ *B. dhe J.*, Aktgjykimi i 17 janarit 2005, para. 629-630.

terrorizuan nga i Pandehuri. Mënyrat në të cilat i Pandehuri kreu rrahjet janë tregues i mizorisë dhe i vuajtjeve mendore të treguara.

331. Viktimat janë rrahur mu jashtë sallës së TV-së, ku të gjithë të burgosurit mund të shihnin veprimet e vazhdueshme. Rrahjet do të shoqëroheshin nga sjelljet që synonin të ndikonin më tutje mentalisht ndaj viktimave, domethënë duke lëshuar këngë nacionaliste dhe duke pjekur mish dhe pire birra derisa viktimat ishin të burgosur në kushte jashtëzakonisht të rënda.
332. Për më tepër, megjithëse disa dëshmitarë kanë deklaruar se ishin rrahur vetëm një herë, ata atëherë nuk e dinin a do të ndodhnin rrahjet përsëri dhe kur. Kjo e kombinuar me faktin se pothuajse të gjithë dëshmitarët janë mbajtur në burgim për një periudhë të gjatë kohe, përforcuan frikën dhe terrorin e tyre se a do të ndodhnin dhe kur do të ndodhnin rrahjet tjera.
333. Në të vërtetë, të gjithë dëshmitarët treguan se si i Pandehuri ishte më i egri nga të gjithë rojet dhe se si niveli i terrorit vazhdoj dhe përsëritej gjatë kohës së ushqimit deri në pikën që disa viktima preferonin t'i lenin pa ngrënë shujtat e tyre se sa të përballëshin me të Pandehurin. Kjo ka të beje gjithashtu edhe me ato viktima që nuk ishin objekt i rrahjeve të drejtpërdrejta, por që megjithatë vuajtën nga ky mjedis i terrorit.
334. Në vijë me atë që u vendos nga Dhoma e Gjykatës së Tribunalit të Hagës në *rastin kampi 'Č.'*, Trupi Gjykues vlerësoi se si krimet e të Pandehurit ishin veçanërisht serioze në aspektin e interesave të mbrojtura që ai shkeli - përkatësisht integritetin fizik dhe mendor të viktimave, pasojat për viktimat (vuajtjet e mëdha fizike dhe mendore që ata ende mbajnë me vete tash), *mënyrën e veprimit* me të cilën ka vepruar i Pandehuri dhe arsyet për të cilat këto krime janë kryer, e që nuk ishte arsye tjetër përveç urrejtjes se dukshme etnike. Urrejtja etnike, e cila u theksua edhe në të gjithë *modus operandin* e përmendur më lart, ku i Pandehuri lëshonte këngë nacionaliste gjatë kryerjes së rrahjeve dhe i thërriste viktimat në bazë të vendit nga vinin dhe ishte veçanërisht i egër ndaj një grupi të caktuar njerëzish (që do të thotë me ata nga fshati B.) pasi që kishte supozime se një i afërm i të Pandehurit ishte vlarë në atë rajon.
335. Trupi Gjykues, prandaj, i ka klasifikuar këto akte si shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare për mënyrën se si ato arritën në shkeljen e dinjitetit personal, veçanërisht si trajtim poshtërues dhe degradues, në formën e shkeljeve të integritetit trupor ose shëndetit dhe vuajtjes të madhe.

- **Përgjegjësia penale individuale**

336. Në pajtim me Nenin 142 të KPRSFJ, kryerësi duhet të urdhërojë ose të kryejë aktin në fjalë.
337. Trupi Gjykues vlerësoi elementët subjektivë (të ashtuquajturit *mens rea*) të të Akuzuarit.

338. Në pajtim me Nenin 11 të KPRSFJ-së, personi është penalisht përgjegjës nëse ai apo ajo është mendërisht kompetent dhe është shpallur fajtor për kryerjen e një vepre penale. Në pajtim me të njëjtën dispozitë, personi është fajtor për kryerjen e veprës penale kur ai ose ajo kryen veprën penale me dashje ose nga pakujdesia.
339. Së pari, nuk ka asnjë dyshim për faktin se i Akuzuari ishte plotësisht kompetent mentalisht kur e kreu veprën. Asgjë në dosjen e lëndës nuk sugjeron ndryshe dhe asnjë kundërshtim i tillë nuk është ngritur nga Mbrojtja.
340. Së dyti, vepra penale mund të kryhet me dashje direke ose eventuale. Personi vepron me dashje direke kur ai ose ajo është në dijeni të aktit të tij ose të saj dhe e dëshiron kryerjen e saj. Personi vepron me dashje eventuale kur ai ose ajo është në dijeni se mund të ndodhë një pasojë e ndaluar si pasojë e veprimit ose mosveprimit të saj dhe ai ose ajo pranon ndodhjen e tij.
341. Trupi Gjykses ka konstatuar se si i Pandehuri ka kryer me dashje veprimet e përshkruara më lart. Ai me dashje i ka vu në shënjestër viktimat dhe kreu kundër tyre veprimet inkriminuese të konstatuara më lart.
342. Për më tepër, Trupi Gjykses gjithashtu konstatoj si të vërtetuar se i Pandehuri ka vepruar në bashkëkryerje.
343. Neni 22 i KPRSFJ-së thotë:
- “Nëse disa persona bashkërisht kryejnë një vepër penale duke marrë pjesë në veprimin e kryerjes apo në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre do të dënohet ashtu siç parashihet për atë vepër”.*
344. Trupi Gjykses ka vlerësuar se si i Pandehuri mund të kryejë të gjitha veprimet e inkriminuara falë faktit se të gjithë të burgosurit tjerë ishin të ruajtur dhe ai asnjëherë nuk ishte ndaluar nga askush. Përkundrazi, siç dëshmuuan Dëshmitarët, në disa raste ai ishte në shoqëri me rojet tjerë gjatë kryerjes së veprimeve të tij.
345. Trupi Gjykses vë në dukje se nuk është e nevojshme që të gjithë bashkëkryerësit të jenë në gjykim ose madje ta dine. Ky përfundim është në përputhje me jurisprudencën vendore dhe ndërkombëtare.
346. Gjykata Supreme e Kosovës thekson si më poshtë në rastin *L. G. dhe tjerë, ku ajo vlerësoj se:*
- “Nënkuptohet se mungesa e informatave për bashkëkryerësit e tjerë nuk mund të çojë në rezultatin që një person ... nuk do të ndiqet penalisht dhe/ose të dënohet sipas ligjit.”⁷¹*
347. Një qasje e ngjashme është ndjekur nga Gjykata Supreme e Kosovës në rastin e *B. K.*⁷²

⁷¹ Vendimi i Gjykatës Supreme në *L. G. dhe të tjerët*, Rasti Ap. - Kz . Nr. 89/2010, 26 janar 2011, f. 24, versioni anglisht.

⁷² Vendimi i Gjykatës Supreme në *B. K.*, rasti Ap .- Kz . Nr. 153/2008, 12 janar 2010, para 21-22, versioni në anglisht

348. Dhoma e Gjykatës e Gjykatës Speciale për S. L. ka pranuar gjithashtu se *mjafton të deklarohet identiteti i kryerësve duke iu referuar kategorisë ose grupit të tyre*⁷³.

349. Së fundi, Trupi Gjykues shqyrtoi veprimet e kryera nga i Pandehuri si vepër e vetme penale sipas Nenit 142 të KP RSFJ.

350. Ne këtë drejtim, Gjykata e Apelit e Kosovës në rastin kundër Z. K. konstaton se:

*“ ... megjë veprat penale të drejtuara kundër integritetit personal, si rregull do të përbëjnë vepra penale individuale, vepra penale Krimi i Luftës kundër Popullatës Civile dhe veprat tjera penale kundër njerëzimit dhe të së Drejtës Ndërkombëtare dallohen në këtë drejtim. Për shkak të natyrës së këtyre veprave penale, ato në përgjithësi drejtohen kundër shumë viktimave. Kjo është, ndër të tjera, e qartë nga vetë formulimi i vetë normës penale (Neni 142 KP RSFJ, Neni 153 KPK). Vepra penale titullohet Krimi i Luftës kundër Popullatës Civile dhe në të gjithë normën përdoret shumësi, p.sh. "popullata civile që i nënshtrohet vrasjeve, torturës, trajtimit çnjerëzor ... marrja e pengjeve, arrestimet e paligjshme ... ”.*⁷⁴

351. Komentari i Nenit 142 të KPRSFJ parasheh që:⁷⁵

“Aktivitetet inkriminuese janë vënë në mënyrë alternative në ligj, kështu që veprimi mund të kryhet nga secili aktivitet. Megjithatë, nëse një person kryen disa veprime identike ose disa aktivitete të ndryshme të inkriminuara në këtë Nen, kjo do të jetë vetëm një vepër penale e krimeve të luftës kundër popullatës civile, pasi që në këtë rast rrjedh nga përshkrimi ligjor i veprës penale se kjo është një vepër penale e vetme, pavarësisht nga numri i aktiviteteve individuale të kryera. Sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Serbisë Kz-2539/56, ekziston një vepër penale e krimeve të luftës kundër popullatës civile, pavarësisht që kryerësi i ka kryer veprimet e veçanta në vende të ndryshme, kundër personave të ndryshëm, në periudha të gjata kohore dhe në mënyrë tjetër”.

352. Trupi Gjykues pajtohet me këtë interpretim të vazhdimit të krimit, pasi që rrahjet e kryera si dhe të gjitha sjelljet e frikësimit të kryera nga i Pandehuri kundër viktimave ishin udhëhequr nga e njëjta mundësi, ato u kryen me të njëjtin qëllim dhe kundër të njëjtit objektiv, përkatësisht civilëve Shqiptarë të burgosur në S.

Përfundimi

353. Në dritën e të gjitha atyre që u vlerësuan më lart, Trupi Gjykues konstaton të provuar se veprat e kryera nga i Pandehuri Z. V. janë të barabarta me Krime të luftës kundër Popullatës civile siç parashikohet dhe dënohet me Nenet 22 dhe 142 të KPRSFJ, aktualisht i kriminalizuar me Nenet 31, 152 dhe 153 të KPK-së, në kundërshtim me Nenin 3 të përbashkët për katër Konventat e Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe të Neneve 4, 5(1) dhe 13 të Protokollit II të 8 qershorit 1977, shtesë e Konventave të Gjenevës të vitit 1949.

⁷³ Shih *Prokurori kundër F. dhe K.*, lënda nr. SCSL-04-14-T, Aktgjykimi i 02 Gushtit 2007, para 38.

⁷⁴ Aktgjykimi i Apelit i datës 25 shtator 2013, para. 87.

⁷⁵ Lj. L., Komentari i Kodit Penal të RFJ-së të vitit 1995, Editioni 5; Savremena Administracija ; Beograd.

G. PËRCAKTIMI I DËNIMIT

354. Kur e cakton sanksionin penal, Gjykata duhet të marrë parasysh edhe qëllimin e përgjithshëm të dënimit, përkatësisht të shtypë aktivitetet shoqërore të rrezikshme duke i frenuar të tjerët që të kryejnë vepra të ngjashme kriminale dhe qëllimin e caktuar, domethënë të parandaloje shkelësin nga përsëritja e veprës penale.
355. Sipas Nenit 34 të KPK-së: “Qëllimet e dënimit janë: 1) të parandaloje kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të beje rehabilitimi i kryerësin: dhe 2) të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale”. Duke pasur parasysh këtë, Trupi Gjykues vendos si në vijim.
356. Duke marrë parasysh hyrjen në fuqi të Kodit të ri Penal të Republikës së Kosovës nga 1 janari 2013 (KPK), dhe nisur nga parimi i zbatimit përfundimtar të *lex mitior*⁷⁶, Trupi Gjykues është dashur të shqyrtojë *konkretisht* se cili ligj është më i favorshëm për të Pandehurin gjatë llogaritjes së dënimit.
357. Siç u tha nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), *lex mitior* është ai që është më i favorshëm për të Pandehurin, duke marrë parasysh karakteristikën e tij apo saj, natyrën e veprës dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra⁷⁷. Prandaj, *lex mitior* duhet të konsiderohet *in concreto*⁷⁸.

Llogaritja e dënimit sipas KPRSFJ

358. KPRSFJ-së ishte i zbatueshëm në datën e kryerjes së veprës penale dhe është mbajtur në fuqi me Nenin 1 paragrafin 1.3 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 të 12 dhjetorit 1999.
359. Pjesa 1 Neni 1.1 e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 e Ligjit të aplikueshëm në Kosovë, ka hyrë në fuqi më 12 dhjetor 1999 , parashikon që:
- “Ligji i aplikueshëm në Kosovë është:*
- (a) Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në bazë të tij; dhe*
- (b) Ligji në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.”*
360. Kjo rregullore është ndryshuar më 27 tetor 2000 me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/59, me të cilën dënimi me vdekje u shfuqizua dhe u zëvendësua me dënimin maksimal prej 40 vjet burgim, sipas Paragrafëve (1.5) dhe (1.6).
361. Vepra penale “Krimi i luftës kundër popullatës civile” është kriminalizuar sipas nenit 142 të KPRSFJ dhe, duke u mbështetur në atë që u tha më lart, do të mbaj dënimin

⁷⁶ Shih rastin *S. kundër I. nr.2*, nr. 10249/03, KEDNJ .

⁷⁷ Shih rastin *S. kundër I. (nr.2)*, nr. 10249/03, para. 109, 17 shtator 2009 ; *M. dhe D. kundër B. dhe H.*, mendime të ndara, faqja 43.

⁷⁸ Shih më sipër, *M. dhe D. kundër B. dhe H.*, faqe 44 .

minimal prej pesë vjet burgim dhe maksimumin prej dyzet vjetësh (në vend e dënimit me vdekje).

362. Megjithatë, Neni 38 Paragrafi (2) i KPRSFJ parashikon që Gjykata mund të caktojë dënimin me burgim për një periudhë prej njëzet vjetësh për veprat penale që janë të pranueshme për dënimin me vdekje (sepse më vonë bëhen dyzet vjet burgim).
363. Lidhur me rregullën e përgjithshme të dënimit me burgim, Neni 38 Paragrafi (1) i KPRSFJ-së thotë që “dënimi me burgim nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë ose më shumë se 15 vjet”.
364. Në rastin në fjalë, Trupi Gjykues e merr parasysh vetëm kategorinë e dënimit me burgim në mes 5 dhe 15 vjet.
365. Lartësia e dënimit të aplikueshëm është, prandaj, ***nga 5 deri në 15 vjet burgim.***

Llogaritja e dënimit sipas Kodit Penal të mëparshëm të Kosovës (KPK i mëparshëm)

366. Kodi i mëparshëm Penal i Kosovës ka hyrë në fuqi në vitin 2004. Lidhur me veprën e njëjtë penale, Neni 120 i KPK-së se mëparshëm parashikonte gjithashtu dënimin jo më pak se pesë vjet ose me burgim afatgjatë.
367. Neni 45 Paragrafi (1) i KPK-së së mëparshëm thotë se “Dënimi me burgim nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë ose më shumë se 20 vjet”.
368. Trupi Gjykues, siç u cek më lart, do të merr parasysh vetëm dënimin me burgim.
369. Lartësia e dënimit të aplikueshëm prandaj do të jete nga ***5 deri në 20 vjet burgim.***

Llogaritja e dënimit sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPK)

370. KPK hyri në fuqi më 01 janar 2013. Lidhur me veprën e njëjtë penale, Neni 152 i KPK parashikon gjithashtu dënimin jo më pak se pesë vjet ose me burgim afatgjatë.
371. Neni 45 Paragrafi (1) i KPK thotë se: “Dënimi me burgim nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë ose më shumë se 25 vjet”.
372. Trupi gjykues, siç u cek më lart, do ta merr parasysh dënimin me burgim.
373. Lartësia e dënimit të aplikueshme prandaj do të jete nga ***5 deri në 25 vjet burgim.***

Lex mitior

374. Trupi Gjykues ka konsideruar se rezultati më i favorshëm për të Pandehurin do të arrihet *in concreto* duke zbatuar KPRSFJ-së.

375. Gjykata e përcakton dënimin për një veprë penale brenda kufijve të parashikuara nga ligji për një veprë të tillë penale, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe, në veçanti, shkallën e përgjegjësisë penale, motivet për kryerjen e veprës, intensitetin e rrezikut ose dëmtimin e vlerës së mbrojtur, sjelljen e kaluar dhe rrethanat personale të kryerësit, sjelljen e tij/saj pas kryerjes së veprës penale dhe të gjitha rrethanat konkrete në të cilat është kryer vepra. Dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe sjelljen dhe rrethanat e kryerësit.
376. Si rrethana rënduese, Trupi gjykues ka marrë parasysh numrin e viktimave, faktin se veprimet e të Pandehurit përbënin disa akte të ndara, faktin se viktimat i janë nënshtruar këtyre akteve gjatë një periudhë të zgjatur kohe, dhe faktin se terrori ishte shkaktuar në mënyrë të përhershme dhe gjithashtu në njerëz që nuk ishin objekt i rrahjeve.
377. Si rrethana lehtësuese, Trupi gjykues mori parasysh mungesën e dosjeve penale dhe faktin që i Pandehuri ka kryer një jetë të mirë profesionale.
378. Duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese të lartpërmendura, Trupi Gjykues e dënoi të Pandehurin me ***gjashtë (6) vjet dhe gjashtë (6) muaj burgim*** për veprën penale “Krimi i luftës kundër popullatës civile” në pajtim me Nenin 142 lidhur me Nenin 22 të KPRSFJ, në formulimin e tij që ka hyrë në fuqi më 1 korrik 1977, që është mbajtur në fuqi nga Pjesa 1 paragrafi 1.3 e Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999.
379. Koha e kryer në paraburgim që nga burgimi i parë i të Akuzuarit më 10 mars 2016 do të përfshihet në dënimin me burgim në pajtim me Nenin 50 Paragrafi (1) dhe (3) të KPRSFJ.

H. SHPENZIMET E PROCEDURËS

380. Në pajtim me Nenin 453 Paragrafin 4 të KPP, shpenzimet e procedurës penale do të kompensohen pjesërisht nga i Pandehuri sipas orarit në shumën prej Euro 300, ndërsa të gjitha shpenzimet tjera të procedurës penale do të paguhet nga burimet buxhetore.

I. KËRKESA PASURORE JURIDIKE

381. Në bazë të Nenit 218 paragrafi (1) dhe (3) lidhur me Nenin 460, paragrafi (3) të KPP, deklaratat e dëmit nga palët e dëmtuara, *ndër të tjera*, do e përshkruajnë personin që ka shkaktuar dëmin, si ka ndodhur dëmi, si është shkaktuar dëmi ose a ishte rezultat i parashikueshëm i veprës penale.
382. Në pajtim me Nenin 463 paragrafi (3) të KPP-së, Gjykata udhëzon palën e dëmtuar që ai ose ajo mund të ndjekë kërkesën pasurore juridike në proces gjyqësor civil, nëse Gjykata merr aktgjykimin për lirim të të akuzuarit për akuzën ose refuzon akuzën ose nëse merr aktvendim për të hedh poshtë procedurën penale.

383. Në pajtim me Nenin 460, paragrafin (3) të KPP, personi i autorizuar për parashtrimin e kërkesës duhet të deklarojë në mënyrë sakte kërkesën e tij ose të saj dhe të paraqesë prova.

Akuza I

384. Sa i përket Akuzës I, Gjykata e ka liruar të Pandehurin Z. V.ç nga akuzat. Si rezultat i kësaj, refuzohen kërkesat pasurore juridike në vijim lidhur me Akuzën I dhe palët e dëmtuara që kanë paraqitur këto kërkesa udhëzohen se mund t'i ndjekin këto kërkesa në proceset gjyqësore civile:

- H. A.

4050 Euro shpenzime të trajtimit mjekësor dhe të holla në vlerë 100 DM.

- R. M.

15.000 DM dhe stoli ari në vlerë 10.000 DM.

- L. M.

2.800 shpenzime të trajtimit mjekësor dhe 2.000 - 3.000 DM, unaza e dasmës e Xh. M. dhe një qafore e arit.

- B. A.

4.700 Euro shpenzime të trajtimit mjekësor si pasojë e lëndimeve të marra.

- V. M.

5.850 shpenzime të trajtimit mjekësor

- Sh. R. G.

9.000 euro dëmshpërblim për shtëpinë, 3.000 euro të holla të vjedhura, 2.000 euro stoli ari të vjedhura, 2.400 euro veture e vjedhur, 1.200 euro për bagëtinë e vranë dhe shpezët.

- B. A.

Mbi 10.000 euro shpenzime të trajtimit mjekësor, 50.000 euro për humbjen e shtëpisë dhe objekteve tjera, 5.000 euro për humbjen e bagëtisë, 2.000 euro të parave të marra, 3.000 për humbjen e stolive të arit dhe 1.000 për humbjen e rrobave dhe ushqimit.

- N. R. G.

8.500 Euro për granatimet dhe djegien e shtëpisë së tij, 3.850 euro për plaçkitje të hollave, 3.500 Euro për plaçkitjen e stolive të arit, 2.950 Euro për vrasjen e bagëtisë dhe shpezëve.

Akuza II

385. Sa i përket Akuzës II, Gjykata e ka shpallur të Pandehurin Z. V. fajtor. Gjykata tani do të vlerësojë secilën kërkesë pasurore juridike lidhur me atë vepër penale.

386. Kërkesa e A. O., që përbëhet nga shuma prej 450 Euro lidhur me shpenzimet e trajtimit mjekësor, hedhet poshtë, sepse kërkesa nuk është saktësuar dhe nuk është paraqitur asnjë provë, siç kërkohet sipas Nenit 460 Paragrafit (3) të KPP.

387. Kërkesa e M. U., që përbëhet nga shuma prej 1.650 Euro lidhur me shpenzimet e trajtimit mjekësor dhe humbjen e të hyrave prej 18.000 Eurosh, hedhet poshtë,

sepse kërkesa nuk është saktësuar dhe nuk është paraqitur asnjë provë, siç kërkohet sipas në Nenit 460 paragrafit (3) të KPP.

388. Kërkesa e B. F., qe përbëhet nga shuma prej 5.000 Euro lidhur me shpenzimet e trajtimit mjekësor dhe kompensimin e 100.000 Eurove për zhdukjen e gjithë pasurisë si pasojë e luftës, hidhet poshtë. Përveç faktit se kërkesa nuk është saktësuar dhe nuk është paraqitur asnjë dëshmi sipas Nenit 460 Paragrafit (3) të KPP-së, i Pandehuri Z. V. nuk është akuzuar për vjedhjen e parave dhe/ose sendeve personale sipas Akuzës III, siç kërkohet sipas Nenit 218 paragrafit (1) të KPP.
389. Kërkesa e S. Rr., qe përbëhet nga shuma 10.250 Euro lidhur me shpenzimet e trajtimit mjekësor dhe shuma prej 16.500 DM që i ishte marrë atij, si dhe rreth 800 DM në Dinarë dhe ora e dorës, si dhe shuma prej 9.500 DM që pretendohet se i Pandehuri e mori prej tij, si dhe automjeti i tij që ishte marr nga forcat serbe dhe vlente 5.000 DM, hedhen poshtë. Përveç faktit se kërkesa nuk ishte saktësuar dhe nuk është paraqitur asnjë dëshmi siç kërkohet sipas Nenit 460 Paragrafit (3) të KPP, i Pandehuri Z. V. nuk u akuzua për vjedhjen e parave dhe/ose sendeve personale sipas Akuzës III, siç kërkohet sipas Nenit 218 paragrafit (1) të KPP.
390. Kërkesa e B. M., qe përbëhet nga shuma prej 800 DM lidhur me shpenzimet e trajtimit mjekësor, vjedhja e stolive të arit në vlerë 3.000 DM si dhe 900 DM në para të gatshme, 1.200 DM shpenzime lidhur me riparimin e traktorit të shkatërruar, 2.000 DM lidhur me riparimin e kamionit në shtëpinë e tij që ishte dëmtuar, 9.000 DM për të kompensuar pesë lopë të vrara dhe 2 viça, 4.000 DM për një automjet që i është marrë dhe 2.500 DM për shpenzimet e nevojshme në Sh., hedhen poshtë. Përveç faktit se kërkesa nuk ishte saktësuar dhe nuk është paraqitur asnjë prove sipas Nenit 460 Paragrafit (3) të KPP, i Pandehuri Z. V. nuk është akuzuar për vjedhje parash dhe/ose vjedhje apo shkatërrim të sendeve personale ose vrasjen e kafshëve sipas Akuzës III, siç kërkohet sipas Nenit 218 Paragrafit (1) të KPP.
391. Kërkesa e Sh. M., qe përbehet nga shuma 400 DM lidhur me shpenzimet e trajtimit mjekësor, 13.100 Euro për operim dhe shuma prej 850 Euro që policia ia mori atij, hedhen poshtë. Përveç faktit se padia nuk ishte saktësuar dhe nuk është paraqitur asnjë prove siç kërkohet sipas Nenit 460 Paragrafit (3) të KPP-së, i Pandehuri Z. V. nuk u akuzua për vjedhjen e parave dhe/ose sendeve personale sipas Akuzës III, siç të kërkohet sipas Nenit 218 paragrafit (1) të KPP.
392. Kërkesa e Sh. B., qe përbëhet nga shuma 1.750 Euro lidhur me shpenzimet e trajtimit mjekësor, hedhet poshtë, sepse kërkesa nuk është saktësuar dhe nuk është paraqitur asnjë prove, siç kërkohet sipas Nenit 460 Paragrafit (3) të KPP.
393. Kërkesa e R. A., qe përbëhet nga shuma 750 Euro lidhur me shpenzimet e trajtimit mjekësor, hedhet poshtë, sepse kërkesa nuk është saktësuar dhe nuk është paraqitur asnjë provë, siç kërkohet sipas Nenit 460 Paragrafit (3) të KPP.

Gjykata Themelore e Mitrovicës

25 maj 2018

Arnout Louter
Kryetar i trupit gjykues

Dariusz Sielicki
Anëtari i trupit gjykues

Radostin Petrov
Anëtar i trupit gjykues

Chiara Tagliani
Procesmbajtëse

MJETI LIGJOR: I Pandehuri, avokati i tij mbrojtës, Prokurori, pala e dëmtuar ose Përfaqësuesi i saj i autorizuar kanë 15 ditë afat nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi të paraqesin ankese në përputhje me Nenet 380(1) dhe 381(1) të KPP. Të gjitha ankesat duhet të paraqiten në Gjykatën e Shkallës së Parë sipas Nenet 388(1) të KPP.